




VRASJA E GJYQTARES

Shoferi i furgonit futi vrasësin e gjyqtares në polici

Fildeze Hafizi sa kishte dalë nga parukeria. Fadil Kasemi refuzoi të flasë para prokurorëve

► FAQE 4-5



MBULIMI I SKËNDERBEUT

Myftiu i Tiranës: Përpjekje për të nxitur përçarje fetare

Gurra: Ekranet, jo për të mbuluar monumentin. Autoritetet i dinë kush janë kërcënuesit e mi

► FAQE 9

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VII - NR. 208

E DIEL, 03-09-2017

www.shqiptarja.com



Çuditë e parlamentit

DEPUTETI I PD QE MORI PARA PER HOTEL GJATE ÇADRES

Zbardhen dokumentet, deputetët u paguan me paratë publike për fjetje gjatë ngujimit në çadër dhe muajit të zgjedhjeve

ADRIATIK DOÇI

► FAQE 2-3

RILINDASI

► FAQE 15-22



Andrea Skanjeti, regjisori që i dha dritën e zemrës teatrit

NGA XHAHID BUSHATI

Gaqo Spiru, aktori durrsak që u dha jetë dhjetra roleve krah yjeve të filmit e teatrit

NGA MARK BRUNGA



Në Majestiku... kinemaja ku thurreshin ëndrra me Çaplin dhe Greta Garbo

NGA NAUM MARA



PERIFERI

NGA Alba MALLTEZI

Dëshira për të vërtetën nuk ka vdekur

Vera e nxehtë e këtij viti, sidomos gushti, solli një fenomen interesant në Shqipërinë e vogël, por me numrin më të lartë të gazetave e të televizioneve për frymë, sa cilido vend i rajonit e Europës: Shqiptarët duan të informohen. Saktë dhe drejtë.

vijon në faqen 10


HISTORI NJERËZORE

Nëna e vetme me djalin 56-vjeçar, të prekur nga sindroma down



Vështirësitë e 76-vjeçares që pas vdekjes së bashkëshortit përballet kujdeset për djalin me aftësi të kufizuara

► FAQE 14



KOMBETARJA

PANUCCI DEBUTON ME FITORE, SHQIPERI - LIECHTENSTEIN 2:0

Kuqezinjtë nuk shkëlqejnë, por dominojnë dhe fitojnë relativisht lehtë, golat nga Roshi e Agolli. Në vendin e tretë me 12 pikë

► FAQE 12-13

Deputeti i PD që mori para për hotel në çadër

Zbardhen dokumentet, deputetët u paguan me paratë publike për fjetje gjatë ngujimit në çadër dhe muajit të zgjedhjeve

Paradoksi

Deputetët të Partisë Demokratike, gjatë ngujimit tremujor në çadër e protestës para Kryeministrit, kanë përfituar para publike për fjetje në hotel brenda vendit.



opozita ishte e fokusuar tek kauza e çadërës, deputetja e PD, Arbiola Halimi ka marrë një pagesë prej 7 500 lekë për rimbursim (nuk

specifikohet shërbimi), 31 355 lekë dieta, 4 349 lekë për karburant dhe 17 000 lekë për telefon. Sipas dokumentacionit zyrtar që disponon Shqiptarja.com, zonja ka përfituar dieta dhe pagesa të tjera edhe gjatë muajve të mëparshëm. Ndërkaq, edhe deputetë të forcave të tjera politike, kryesisht të Partisë Socialiste, janë paguar nga paratë publike për fjetje në hotele brenda vendit. Gjatë muajit prill 2017, deputetja Adelina Rista është paguar me 36 000, Andrea Marto ka shpenzuar 18 000 lekë, Arta Dade 18 000 lekë, Arjeta Alhysa 9 000 lekë, Luljeta Arapi 36 000, Mimoza

Hafizi 3 000 lekë dhe Mira Shehu ka shpenzuar 36 000 lekë nga paratë publike për fjetje në hotel brenda vendit, për shërbime që lidhen me detyrën si ligjvënës. Por, ndryshe nga deputetët e PS, të cilët mund ta justifikojë edhe formalisht fjetjen në hotel, nuk dihet se si deputetët e PD i kanë justifikuar këto pagesa, në kushtet kur Partia Demokratike, gjatë kësaj periudhe, kishte ndërprerë çdo marrëdhënie me Parlamentin. Gjithsesi, dokumentet konfirmojë se marrëdhëniet financiare me deputetëve të opozitës dhe Kuvendit kanë qenë më të forta se kurrë më parë.



JASHTË VENDIT

Për periudhën janar-korrik 2017, gjashtë deputetë kanë shpenzuar para publike për fjetje në hotele jashtë vendit, katër përfaqësues të opozitës dhe dy të Partisë Socialiste. Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Edi Paloka, ka shpenzuar 336 USD për hotel jashtë vendit, kryetari i Partisë Republikane Fatmir Mediu ka shpenzuar 1 140 USD, deputeti demokrat Gerti Bogdani ka shpenzuar 1 364 USD, deputetja Jozefina Topalli ka shpenzuar

956 USD, deputeti socialist Namik Dokle ka shpenzuar 746 USD dhe deputeti socialist Pandeli Majko ka shpenzuar 1 140 USD për hotel jashtë vendit.

BILANCI

Vetëm gjatë muajit prill të vitit 2017, deputetët e parlamentit shqiptar kanë shpenzuar 14 325 556 lekë nga paratë publike për dieta, telefon, karburant etj. Shumica e deputetëve kanë shpenzuar më shumë se sa 1 mijë USD për një muaj, pa llogaritur pagën bazë. Deputetët që kanë

PËRFITIMET E TË GJITHË DEPUTETËVE GJATË MUAJIT PRILL 2017

Agron Çela	132 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Agron Duka	48 214 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Adelina Rista	188 650 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Albana Vokshi	90 718 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Alban Zeneli	57 000 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Albina Deda	126 285 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Alfred Peza	57 502 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Aldo Bumçi	88 660 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Anastas Angjeli	104 825 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Andrea Marto	133 025 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Anila Agalliu	182 400 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Antoneta Dhima	139 050 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Anduel Xhindi	144 150 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Arben Çuko	142 450 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Arben Imami	119 681 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Arben Ristani	135 650 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Arbjo Halimi	125 952 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Arta Dade	134 504 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Artan Gaçi	99 941 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Aqif Rakipi	88 327 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Asllan Dogjani	84 641 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Astrit Patozi	132 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Astrit Veliaj	94 625 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Bashkim Fino	77 400 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Bedri Hoxha	123 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Bedri Mihaj	94 625 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Ben Blushi	90 027 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Besnik Baraj	75 516 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Blerina Gjylameti	60 616 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Blendi Klosi	106 239 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Bujar Derveni	106 239 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Bujar Kllogjeri	132 752 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Bujar Çela	152 650 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Dashamir Peza	105 041 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.

Dashamir Shehi	84 641 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Dashamir Kamberi	109 925 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Edi Paloka	93 285 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Edlira Çekrezi	169 302 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Edmond Spaho	45 026 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Eduart Bejko	150 950 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Eduard Halimi	85 839 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Eduard Selami	50 702 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Eduard Ndoci	51 035 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Eleina Qirici	162 000 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Enkeleja Shkreli	88 041 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Erion Braçe	112 245 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Ervin Bushati	105 041 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Erjeta Alhysa	105 541 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Evis Kushi	64 302 për lekë dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Esmeralda Shkaj	140 464 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Fatmir Mediu	63 400 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Fatmir Toçi	127 025 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Fidel Ylli	99 725 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Flamur Noka	94 625 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Florion Mima	47 016 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Genc Pollo	99 504 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Genc Ruli	94 625 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Gent Strazimiri	89 239 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Gentian Bejko	143 864 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Gerti Bogdani	84 641 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Gjergj Papa	132 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Gjovalin Bzhetaj	162 000 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Gledion Rehovica	142 450 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Gamoz Ruçi	104 969 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Helidon Bushati	132 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Igli Cara	123 464 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Ilir Meta	0 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Ilir Xhakolli	140 750 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.

Pikëpyetja

Ndryshe nga deputetët e PS, të cilët mund ta justifikojë edhe formalisht fjetjen në hotel, nuk dihet se si deputetët e PD i kanë justifikuar këto pagesa, në kushtet kur Partia Demokratike, gjatë kësaj periudhe, kishte ndërprerë çdo marrëdhënie me Parlamentin.

DEPUTETËT QË FJETËN NË HOTELE BRENDA VENDI ME PARATË PUBLIKE

Mimoza Hajdarmataj	36 000 lekë hotel në muaj prill 15 000 lekë për muajin qershor.
Adelina Rista	36 000 lekë hotel brenda vendit prill 2017
Andrea Marto	18 000 lekë hotel brenda vendit prill 2017
Arta Dade	18 000 lekë hotel brenda vendit prill 2017
Arjeta Alhysa	9 000 lekë prill 2017
Fatmir Toçi	12 000 lekë prill 2017
Luljeta Arapi	36 000 lekë hotel brenda vendit prill 2017
Mimoza Hafizi	3 000 lekë prill 2017
Mira Shehu	36 000 lekë hotel brenda vendit prill 2017
Ylli Ziçishti	12 000 lekë hotel brenda vendit prill 2017
Dashmir Kamberi	18 000 lekë hotel brenda vendit shkurt 2017
Eduard Shalsi	3 000 lekë hotel brenda vendit shkurt 2017
Ulsi Manja	36 000 lekë hotel brenda vendit shkurt 2017
Valentina Leskaj	18 000 lekë hotel brenda vendit shkurt 2017

SHPENZIMET E DEPUTETËVE PËR FJETJE NË HOTEL JASHTË VENDIT JANAR-KORRIK 2017


Edi Paloka	336 USD, shpenzime për hotel jashtë vendit
Fatmir Mediu	1 140 USD, shpenzime për hotel jashtë vendit
Gerti Bogdani	1 364 USD, shpenzime për hotel jashtë vendit
Jozefina Topalli	956 USD, shpenzime për hotel jashtë vendit
Namik Dokle	746 USD, shpenzime për hotel jashtë vendit
Pandeli Majko	1 140 USD, shpenzime për hotel jashtë vendit

përfitur më shumë para gjatë këtij muaji janë Anila Agalliu 182 400 lekë, Edmond Leka 182 400 lekë, Gjovalin Bzhetaj 162 000 lekë, Eleina Qirici 162 000 lekë, Bujar Çela 152 650 lekë, Eduart Bejko 150 950 lekë, Edmond Zejno 147 550 lekë, Edmond Zejno 147 550 lekë, Anduel Xhindi 144 150, Gledion Rehovica 142 450 lekë, Xhevit Bushaj 140 750 lekë, Vangjel Tavo 139 050 lekë, Arben Ristani 135 650 lekë, Flamur Çelaj 135 650 lekë, Vangjel Dule 132 250 lekë, Gjergj Papa 132 250 lekë etj.

Reagimi i deputetes

Përfitoi dieta në çadër, Halimi: Mos u kthefsha më

Deputetja e Partisë Demokratike, Arbjola Halimi ka reaguar dje ndaj shkrimit të Shqiptarja.com, ku janë zbardhur paratë që kanë marrë deputetët e PD nga Kuvendi i Shqipërisë, gjatë kohës që ishin të ngjuar në çadër. Zonja Halimi ka përfitur 125 mijë e 952 lekë të



reja dieta dhe karburant gjatë çadërës. Por, në një reagim në Facebook, ajo mohon të ketë marrë para nga buxheti i shtetit. Ajo shkruan gjithashtu se gjithçka është një sulm i porositur ndaj saj. Megjithatë, ajo thotë se ditën që e hoqën nga lista e kandidatëve për deputetë, e ka përjetuar si një ndër ditët më të lumtura të jetës së saj. "Kjo është e turpshme po aq sa e neveritshme. E porositur si një sulm nga njerëz të vegjël në shpirt e në moral. Sqaroj për publikun se ditët e qëndrimit në çadër jo vetëm që nuk jemi paguar, por kemi mbuluar gjithçka me shpenzimet tona. Asnjëri nga ne nuk u ankua edhe pse për shumë nga ne rroga ishte i vetmi burim. E neverisë lajmin e ndarë sot në media dhe ndihem

me turp që kam bërë politike për t mbrojtur të drejtat e këtyre fajësor individësh. Është kjo njëra nga arsyt (e deklaroj sot publikisht) pse, ditën që më hoqën nga lista e përjetova si një nga ditët më të lumtura të jetës sime dhe ishallah mos u kthefsha kurrë!", shkruan Halimi. Megjithatë, sipas dokumenteve zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, e vërteta është se zonja Halimi ka përfitur para publike gjatë ngujimit në çadër.

Ilirian Pendavinji	63 800 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Irma Kopluku	162 000 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Jorida Tabaku	84 641 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Jozefina Topalli	132 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Kastriot Islami	88 041 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Keltis Kruja	122 266 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Klodiana Spahiu	130 264 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Kozma Dashi	132 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Kejdi Mehmetaj	84 641 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Liljana Elmazi	132 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Luan Duzha	116 578 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Luan Rama	136 152 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Luçiano Boçi	125 952 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Luljeta Arapi	182 352 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Majlinda Bregu	50 016 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Mesila Doda	107 911 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Mimoza Hafizi	97 625 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Mimoza Hajdarmataj	130 625 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Mira Shehu	104 900 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Mirela Ferracaku	137 350 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Mëhill Fufi	146 685 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Monika Kryemadhi	51 035 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Musa Ulqini	98 527 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Myqerem Tafaj	47 016 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Namik Kopluku	113 325 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Namik Dokle	99 439 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Nard Ndoka	82 500 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Oerd Bylykbashi	127 717 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Omer Mamo	116 837 për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Pandeli Majko	67 416 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Parid Cara	47 016 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Paulin Sterkaj	62 100 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Përparim Spahiu	99 725 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Pirro Kapurani	180 700 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.

Pirro Lutaj	115 025 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Pjerin Ndreu	86 341 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Rakip Suli	105 041 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Ridvan Bode	94 625 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Robert Bitri	150 950 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Roland Keta	132 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Sadri Abazi	88 041 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Sali Berisha	47 016 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Silva Caka	115 025 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Shkëlqim Troplini	131 964 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Shpëtim Idri	48 426 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Spartak Braho	93 770 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Tahir Muhedini	105 041 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Taulant Balla	63 452 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Tom Doshi	74 000 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Ulsi Manja	118 425 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Valentina Leskaj	55 626 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Vangjel Dule	132 250 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Vangjel Tavo	139 050 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Vasilika Hysi	78 916 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Vexhi Muçmataj	73 471 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Vladimir Kosta	63 800 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Xhemal Qefalia	105 041 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Ylli Shehu	86 341 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Ylli Ziçishti	75 800 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Shkëlqim Cani	104 825 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Edmond Leka	182 400 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Dhurata Çupi	94 625 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Flamur Çelaj	135 650 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Edmond Zejno	147 550 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Xhevit Bushaj	140 750 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Petrit Gjoni	139 885 lekë për dieta, telefon, karburant dhe fjetje.
Totali i shpenzimeve	14 325 556 lekë

ELTON QYNO
TIRANE

Shoferi i furgonit futi vrasësin e gjyqtares në polici

Fildeze Hafizi sa kishte dalë nga parukeria Kasemi refuzoi të flasë para prokurorëve

Fadil Kasemi, menjëherë pasi ka qëlluar me plumbë ish-gruan e tij është larguar me ndadalë nga vendi i ngjarjes. Nga krismat e armës, shumë banorë të zonës janë larguar me vrap, ndërkohë Kasemi ka dalë në mes të rrugës dhe nën presionin e armës ka detyruar shoferin e një furgoni me inicialet K.T., të ndalojë në mes të rrugës automjetin e tij. Kasemi ka hipur brenda në furgon dhe sërisht nën kërcënimin e armës e ka detyruar drejtuesin e mjetit që ta nxirte jashtë Tiranës, menjëherë. Por dëshira e tij për tu larguar nga vendi i krimit duke shpresuar të humbte gjurmët për policinë nuk ka zgjatur shumë, pasi ai është arrestuar rreth 800 metra larg vendit të krimit, brenda në furgon. Ndalmi i tij është bërë në oborrin e komisaritit nr.1 në Tiranë.

SHOFERI FUTI FURGONIN NË POLICI

Sipas dosjes penale të prokurorisë më datën 31 gusht 2017, rreth orës 13:50, në rrugën "Xhanfize Keko", Tiranë, në kohën që shtetasja Fildeze Hafizi, banuese në Tiranë, njëkohësisht me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka dalë nga parukeria dhe është futur brenda në automjetin e saj të parkuar aty pranë, benz me targa AA 880 OS. Në këtë kohë është afruar ish-bashkëshorti i saj, shtetasi Fadil Kasemi me një pistoletë në dorë dhe ka qëlluar me armë në drejtim të shtetasës Fildeze Hafizi, duke e lënë të vdekur në vend. Më pas shtetasi Fadil



Fadil Kasemi

Masa e "arrestit në burg"

Prokuroria për Krime të Rënda ka dërguar mesditën e djeshme në gjykatë kërkesën për caktimin e masës së sigurisë "arrest me burg" për shtetasin Fadil Kasemi, për kryerjen e veprave penale të "vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare", "armembajtje pa leje" dhe "rreëmbim personi". Në këto kushte, nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda kërkohet të caktohet ndaj Fadil Kasemi masa e sigurimit "arrest në burg".



TRE AKUZA PËR KASEMIN

"Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare"

"Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit"

"Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit"

Refuzoi të dëshmojë

I pyetur për faktin e ngjarjes, personi i arrestuar Fadil Kasemi, në praninë e një mbrojtësi kryesisht, pasi është njohur me letrën e të drejtave si person i arrestuar, ai nuk ka pranuar të flasë për faktin dhe rrethanat e ngjarjes.



Kasemi me pistoletën në dorë i ka dalë përpara një automjeti të rastit që po udhëtonte në drejtim të rrugës "Bardhyl", automjetit furgon "Benz

Mercedes", që drejtohej nga shtetasi K.T. të cilit i ka thënë se kishte vrarë bashkëshorten e tij dhe nën kërcënimin e armës i ka kërkuar atij që ta

largonte nga vendi i ngjarjes duke hypur brenda në automjetin. Gjatë udhëtimit shtetasi K.T. ka përshkuar rrugën që të dërgonte pranë komisaritit të Policisë nr.1 Tiranë. Në kohën që i është afruar Komisaritit shtetasi K.T. e ka futur menjëherë automjetin e tij brenda në ambientet e komisaritit të Policisë ku në këtë moment janë afruar menjëherë punonjësit e policisë, të cilët kanë ndërhyrë dhe kanë bërë kapjen në flagrancë të shtetasit Fadil Kasemi, duke i hequr armën pistoletë që mbante në duar.



Policia në vendin e ngjarjes ku Fadil Kasemi vrau ish-gruan, Fildeze Hafiz



Fildeze Hafizi



Lutja në Golem

"Fildesi i është lutur që të mos i linte fëmijët jetimë si dhe ka tentuar t'i marrë çantën. Fadili ka reaguar duke e goditur në fytyrë me grusht dhe e ka rrëzuar në rërë,"-nënvizohet në vendimin e gjykatës.



Vesete Kasemit

Çifti Hafizi-Kasemi, ka patur probleme e mosmarreveshje gjatë kohëve të fundit, ku shkak besohet se kanë qënë veset e këqija të Kasemit, bigjozi, alkooli, dhuna në familje etj.

E BRAKTISUR NGA TË GJITHË

Prokuroria injoroi kallëzimin e gjyqtares Hafizi

Hafizi ka paralajmëruar vrasjen pasi i është drejtuar edhe Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë me kallëzim për ndjekje penale të të pandehurit Fadil Kasemi për veprën penale të "dhunës në familje" dhe "Kanosja" duke pretenduar se Fadili, ka ushtruar ndaj saj në mënyrë sistematike dhunë psikologjike duke i cënuar integritetin psiko-social. Në këtë kallëzim është pretenduar se Fadili ka patur një pistoletë të cilën e ka nxjerrë nga xhepi, por pa kryer veprime të tjera me të. Por për këtë kallëzim, prokuroria



e Tiranës nuk e ka vënë "ujin në zjarr" dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit penal më datën 13 prill 2015. Të dhënat e ofruara nga dokumentet gjyqësore tregojnë se 39-vjeçarja Hafizi ndodhej prej më shumë se dy vitesh nën kërcënimin e vazhdueshëm të ish-bashkëshortit të saj, Fadil Kasemi dhe ndonëse e kishte denoncuar në gjykatë dhe prokurori, nuk ia doli të parandalonte fundin e saj tragjik. Pavarësisht konstatimit të dhunës së përsëritur, trupa gjyqësore e drejtuar nga gjyqtari Luan Lusha vendosi më 28 prill

2016 dënimin me 3 vjet burg për Fadil Kasemin-i cili përfitoi më parë edhe nga gjykimi i shkurtuar. Megjithatë, Kasemi u lirua vetëm 1 vit e gjysmë pas arrestimit për shkak të ligjit të qeverisë "Për dhënë amnistie". Urdhri i lirimimit të parakohshëm të Fadil Kasemit, tregon se ai u lirua nga burgu i Rrogzhinës më 14 janar 2017, ndërsa iu falën 11 muaj e 8 ditë burg. Publikimi i këtij fakti dhe i të dhënave të tjera që tregojnë se gjyqtarja Hafizi u braktis në fatin e saj shkaktuan reagime të forta në Tiranë.



Dhuna në familje gjunjëzon Shqipërinë, 450 raste në 2 muaj

99% e të dhunuarve gra e vajza. Në 6 muaj në Gjykatën e Tiranës janë kërkuar 673 urdhra mbrojtje



Momenti ku burri gjuan gruan në qytetin e Vlorës

Denoncimet

Dhuna ndaj grave, 3 burra në pranga brenda 24 orëve

Vrasja e gjyqtarës Fildeze Hafizi, 38-vjeçe, nënë e dy fëmijëve, nga ish-bashkëshorti i saj, ka vënë në lëvizje Policinë e Shtetit, për të marrë masa dhe nisë një aksion kundër dhunës në familje. Policia ka arrestuar edhe tre persona të tjerë të cilët akuzohen për dhunë ndaj bashkëshorteve të tyre. Gjatë 24 orëve të fundit policia e Tiranës arreston 3 shtetas për veprën penale "Dhunë në familje". Konkretisht janë arrestuar për veprën penale të "Dhunë në familje", shtetasit: – Selman Murati, 40 vjeç, banues në Tiranë, pasi ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj bashkëshortes, shtetas L.M., 37 vjeçe, banuese në Tiranë. – Serjan Gojani, 25 vjeç, banues në Kasallë (Kamëz), pasi ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj kumatës së motrës së tij, shtetas A.P., 32 vjeçe, banuese në Kasallë (Kamëz). Albert Ismaili, 42 vjeç, banues në fshatin Picar – Vorë, pasi ka kanosur me jetë dhe ushtruar dhunë fizike ndaj bashkëshortes, shtetas Dh.I., 35 vjeçe, banuese në fshatin Picar – Vorë. Materialet u referuan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur për veprën penale "Dhunë në familje" parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.

Dhuna në familje ka gjunjëzuar shoqërinë shqiptare. Veç vrasjeve të bujshme, dhuna është e pranishme çdo ditë me dhjetra raste. Në muajt qershor dhe korrik në të gjithë vendin janë denoncuar 450 raste. Ndërkohë në 6 muaj në Gjykatën e Tiranës janë kërkuar 673 urdhra mbrojtje. Vetëm dje janë bërë 14 kallëzime për dhunën e burrit ndaj gruas. Për muajt Qershor-Korrik 2017 janë shënuar 449 raste dhune, ku thuajse 99% e viktimave kanë qenë gra, vajza, bashkëshorte dhe ish-bashkëshorte. Sipas buletinit zyrtar të policisë së shtetit, për muajt qershor 2017, janë trajtuar nga policia 195 raste dhune në familje. Dhuna është ushtruar në am-

biente familje, apo për shkak të marrëdhënieve në familje, ndërsa në pranga për muajt qershor kanë rënë 66 dhunues, 12 janë shpallur në kërkim dhe 260 persona janë proceduar në gjendje të lirë.

Alarmante paraqitet situata dhe për muajt korrik, ku janë shënuar 60 raste më shumë, përkthyer në dy gra të dhunuara çdo ditë më shumë në krahasim me qershor. Policia e shtetit sqaron se përgjatë korrikut ka ndërhyrë në 254 konflikte me dhunë në familje, ka arrestuar 71 autorë të këtyre krimeve dhe 318 persona i ka proceduar në gjendje të lirë. Ndërkohë 10 autorë të dhunës në familje, përgjatë korrikut, kanë mundur ti shpëtojnë arrestimit dhe janë shpallur në kërkim. Në korrik të 2017-

Raporti i policisë për dhunën në familje

SHIFRAT PËR MUAJIN QERSHOR 2017

- 195 konflikte me dhunë në familje
- 66 persona të arrestuar
- 260 persona të proceduar në gjendje të lirë
- 12 janë shpallur në kërkim

SHIFRAT PËR MUAJIN KORRIK 2017

- 254 konflikte me dhunë në familje
- 71 persona të arrestuar
- 318 persona të proceduar në gjendje të lirë
- 10 janë shpallur në kërkim

ës dhuna në familje shënoi dhe një viktimë ku 21 vjeçari Mirald Metallri ekzekutoi me armë zjarri babin e tij polic dhe shkak ishte debate për një karrocë me beton teksa familja Metallari përgatitej për dasmë pasi martonte vajzën.

Situata kritike paraqitet

dhe për muajt gusht ku dhe pse s'janë publikuar shifrat zyrtare në të gjithë vendin rezultojnë afro 200 raste ndërsa i tillë ka nisur dhe shtatori ku vetëm më 24 orët e para të tij më 1 shtator 2017 janë shënuar 14 raste dhune dhe në tiranë janë arrestuar 3 persona.

AVOKATJA VJOLLCA PUSTINA: URDRAT E MBROJTJES NUK ZBATOHEN

Urdhrat e mbrojtjes, 433 raste pushohen nga Gjykata e Tiranës

Kërkesa për të marrë urdhër mbrojtjeje është rritur vitet e fundit. Vetëm për periudhën janar – gusht 2017, nga të dhënat e marra nga Gjykata e Tiranës janë 673 urdhra mbrojtjeje të depozituara, prej të cilave 137 janë pranuar, ndërsa 433 raste janë pushuar nga gjykata. Sipas avokates Vjollca Pustina, kjo ndodh pasi palët nuk paraqiten në gjykatë pas denoncimit. "Në fakt urdhrat e



Vjollca Pustina

mbrojtjes nga viti në vit janë rritur. Rezulton që numri i kallëzimeve të mbërritura në Gjykatë është shumë i lartë dhe marrja e urdhrave të mbrojtjes nga Gjykata me vendim është shumë i vogël. Kjo vjen sepse palët, në rastin konkret i dhunuari dhunuesi nuk paraqiten në Gjykatë dhe kjo e fundit në këto kushte e pushon çështjen," u shpreh avokatja. Sipas avokates Pustina, problem mbetet zbatimi i urdhrave

të mbrojtjes, pasi numri i inspektorëve të policisë është i vogël përballë popullësisë që ata mbulojnë. "Një inspektor që mbulon një zonë të caktuar ka nën juridikison rreth 6 mijë deri 22 mijë banorë. A mundet që një inspektor zone të mbulojë e kontrollojë kaq shumë njerëz. Duhet që organet e policisë të punojnë pak më shumë, te ketë të paktën të ketë pak më shumë inspektorë të zonave," shton Pustina. Vjollca Pustina

sqaron se nevoja për urdhër mbrojtjeje vjen zakonisht si pasojë e maskilizmit të shoqërisë shqiptare, që nuk pranon që hapin e divorcit e ndërmerr gruaja. Vetëm para 2 ditësh gjyqtarja Fildeze Hafizi u ekzekutua nga ish bashkëshorti i saj edhe pse kishte një urdhër mbrojtjeje nga gjykata. Ndërkohë që një tjetër grua denoncoi publikisht dhunën nga ish bashkëshorti, duke kërkuar mbrojtje nga institucionet.

Itali, kapen 2.3 tonë marijuan, pranga italianit e shqiptarit

Skafistët i shpëtojnë ndjekjes nga policia italiane, sekuestrohet droga

Sasi rekord droge është kapur në San Benedetto, Itali nga Guardia di Finanza. 2.3 ton kanabis, dy të arrestuar mes tyre një 63 vjeçar italian dhe një 24 vjeçar shqiptar është bilanci i operacionit të kryer në mbrëmjen e të premtes dhe orët e para të mëngjesit të kësaj të shtune. Sasia e drogës dhe operacioni konfirmohet dhe nga policia shqiptare e cila deklaron se po kryen hetime intensive me policinë italiane atë kroate dhe malazeze. Ende nuk ka asnjë të dhënë nga është nisur droga por hetuesit dyshojnë se origjina e saj është bregdeti i Vlorës.

SKAFISTËT I SHPËTOJNË NDJEKJES NGA POLICIA

Siç duket edhe nga video e shpërndarë nga policia italiane të gjurmimit të gomones me drogë ajo ka ndjekur itinerarin drejt plazhit të San Benedetto dhe në kthim, ka mundur t'i shpëtojë ndjekjes. Në cilësinë e provës materiale hetuesit kanë mundur të sekuestrojnë dhe një sasi të konsiderueshme karburanti të vendosur në bidona që do të përdorej për gomonen në kthim.

VLERA E DROGËS NË TREG, 20 MLN EURO

Në rast se droga do të dilte në treg do të kapte vlerën e 20 milionë eurove, ndërsa pritet që edhe në Shqipëri të ketë persona të ndaluar për këtë rrjet të trafikut ndërkombëtar. Mediat italiane bëjnë me dije se dy personat e kishin ngarkuar lëndën narkotike në një furgon. Marijuana ishte e ndarë në 40 pako. Policia po ashtu ka sekuestruar edhe 625 litra benzinë e ndarë në 73 bidona. Ajo çka mbetet e paqartë është fakti si arriti ky grup kriminal të çojë një dërgesë kaq të madhe droge? Vetëm pak orë më parë policia e shtetit bëri bilancin e një operacioni masiv antidrogë në terren duke kontrolluar

Në 40 pako

Marijuana ishte e ndarë në 40 pako. Policia po ashtu ka sekuestruar edhe 625 litra benzinë e ndarë në 73 bidona. Ajo çka mbetet e paqartë është fakti si arriti ky grup kriminal të çojë një dërgesë kaq të madhe droge.

Dy të arrestuar

Të arrestuar nga policia italiane janë K.D 24 vjeç dhe shtetasi italian R.A 63 vjeç, këta dy shtetas janë ndaluar teksa udhëtonin me një furgon pasi kishin marrë drogën në plazhin e San Benedetto.



U ARRESTUA NJË SHQIPTAR DHE ITALIAN Policia Shqiptare: Gomonia oqeanike u zhduk drejt Kroacisë ose Malit të Zi

Në lidhje me një sasi prej 2322 kg lëndë narkotike të sekuestruar nga GdF në zonën e "San Benedetto" Itali ju informojmë se gomonia oqeanike ka mundur të shkarkojë në breg të detit lëndën narkotike dhe është larguar në ujrat detare mes Kroacisë dhe Malit të Zi, duke i shpëtuar ndjekjes së skuadrave të GdF. Skuadrat e GdF në afërsi të bregut në zonën e "San Benedetto" kanë sekuestruar lëndën narkotike të hedhur nga gomonia në një sasi prej 2322 kg e dyshuar marjuanë dhe 625 litra benzene si dhe kanë arrestuar dy persona të cilët ishin me një furgon gati për

të transportuar lëndën narkotike, konkretisht: shtetasi shqiptar rezident në Itali K.D, 24 vjeç dhe shtetasi italian R.A. 63 vjeç. Vijnë hetimet e përbashkëta Itali-Kroaci-Mal i Zi dhe Shqipëri, ku ka një shkëmbim intensiv të informacioneve me policinë italiane dhe Guardia di Finanza për hetimin e rastit, por nuk ka elemente që lidhin këtë rast trafikimi me Shqipërinë. Gomonia ka mundur t'i shpëtojë ndjekjes që ka zgjatur disa orë derisa ka humbur gjurmët në ujërat mes Kroacisë dhe Malit të Zi. Vijnë kontrolli në det për gjetjen e gomones dhe arrestimin e trafikantëve.

Reagimi

Droga e kapur në Itali, Basha: Rama mashtron ndërkombëtarët

Kreu i PD-së: projekti PS: PS+drogë+kriminelë+korrupsion

Kreu i PD-së ka reaguar në lidhje me 2.3 ton drogë të kapur dje në Itali. Me anë të një statusi në facebook, Basha e cilëson si një të vërtetë të hidhur. "Trumpetat e Edi Ramës për luftë kundër drogës janë vetëm mashtrime me qëllim tultajen e qytetarëve dhe të komunitetit ndërkombëtar", shkruan Basha. Ai shton më tej se kjo faktohet edhe me promovimin e Gramoz Ruçit, ndërsa e akuzon se po mashtron edhe ndërkombëtarët. Sasia e drogës u kap në San Benedetto, Itali nga Guardia di Finanza, ku u arrestuan dy persona, mes tyre një 63

vjeçar italian dhe një 24 vjeçar shqiptar.

POSTIMI I PLOTË I BASHËS NË FACEBOOK:

Ngarkesa prej 2,3 tonë drogë e kapur sot në Itali dëshmon një të vërtetë të hidhur: trumpetat e Edi Ramës për luftë kundër drogës janë vetëm mashtrime me qëllim tultajen e qytetarëve dhe të komunitetit ndërkombëtar. Ndërkohë ai mbron dhe promovon kokat e kimit të organizuar dhe bashkëpunëtorët e tyre politikë. Ky në fakt është projekti PS+ i shpallur prej tij: PS+drogë+kriminelë+korrupsion. Kjo faktohet edhe

nga promovimi prej tij i Gramoz Ruçit të cilit që nga 2005 qeveria amerikane i ka refuzuar hyrjen në SHBA për shkak të përfshirjes në krimin e organizuar dhe trafikun e drogës, dhe Fatmir Xhafës të përfshirë në mbrojtjen e të vëllait të dënuar nga Italia për trafikun ndërkombëtar të kokainës. Opozita do të bëjë çdo përpjekje për ta vënë atë para përgjegjësisë personale për drogën dhe krimin. Por kjo betejë kërkon edhe përpjekjet e medias, intelektualëve dhe të gjithë qytetarëve. Të gjithë duhet të ngremë zërin dhe të ngrihem kundër rrezikut të drogës para se të jetë vonë.

të gjithë vijën bregdetare shqiptare por nuk u zbulua një sasi e tillë. Një informacion i vlefshëm për hetuesit italianë dhe ata shqiptarë është dhe

kodi i përdorur në këtë trafik. Siç duket edhe nga pamjet, droga është e paketuar me thasë nga 15-25 kg dhe secili prej tyre ka iniciale të ndrysh-

hme sipas personit që do t'i dërgohet dhe trafikantëve mes tyre janë E.D, T.T, D.T, F.R, I, H. Të arrestuar nga policia italiane janë K.D 24 vjeç dhe

shtetasi italian R.A 63 vjeç, këta dy shtetas janë ndaluar teksa udhëtonin me një furgon pasi kishin marrë drogën në plazhin e San Benedetto.

Dibër

Tre persona në pranga për drogë e dhunë ndaj efektivëve

Tre persona janë arrestuar nga policia në kuadër të operacioneve për kapjen e personave në kërkim, të atyre që qarkullojnë me armë zjarri pa leje dhe atyre që mbajnë apo trafikojnë lëndë narkotike. Policia e Dibërës ka arrestuar në flagrancë Olsi Toska, 24 vjeç, Astrit Buci, 34 vjeç, dhe Altin Margjoka, 30 vjeç. Arrestimi i Astrit Bucit dhe Altin Margjokës është bërë për kundërshtim dhe goditje të punonjësit të policisë. Sipas informacioneve paraprake, në çastin e shoqërimit nga policia Astrit Buci ka goditur punonjësit e policisë dhe më pas ka ndërhyrë shoku i tij Altin Margjoka, i cili ka goditur policët për mos shoqërimit e shokut të tij. Ndërsa Olsi Toska është arrestuar pasi në momentin kur policia ka shkuar për kontroll në banesën e dajës së tij Astrit Bucit, është kapur duke dalë me një kovë ku brenda saj kishte 0.5 kg lëndë narkotike, cannabis sativa. Tre të arrestuarit do të përballen me akuzat "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike" dhe "Kundërshtim me dhunë i punonjësit të policisë".

“Nuk kam dëshmi për shkeljen e të drejtave të grekëve”

Athina notë proteste në BE, për prishjen e ndërtimeve pa lejë. Hahn i jep përgjigje

Komisioneri i Zgjerimit dhe Fqinjësisë, Johannes Hahn është pozicionuar mbi prishjet e ndërtimeve në Himarë, çështje për të cilën Tirana ka marrë një notë proteste nga Athina zyrtare, e cila pretendon për shkelje të të drejtave pronësore të minoritetit grek. Pak ditë pas reagimit të ashpër të Ministrisë së Jashtme greke, nga Komisioni European është kërkuar të mbajë një qëndrim mbi këtë çështje. Eurodeputetja greke Sofia Sakorafa i është drejtuar me një letër komisionerit Hahn, të mbajë një qëndrim nëse veprimet e Shqipërisë janë në përputhje me standardet europiane për trajtimin e pakicave apo kriteret e para-pranimit që kërkohet të përmbushen.

S'KA DËSHMI PËR SHKELJE TË DREJTASH

Në pyetjen e saj, znj. Sakorafa vë në dukje se sundimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave, e cila është e lidhur shprehimisht me mbrojtjen e pasurisë së



pakicave është në qendër të politikës europiane për zgjerimin dhe është një kriter themelor para se Shqipëria të fillojë negociatat e pranimit. Në përgjigje të këtyre pyetjeve, komisioneri Hahn thotë se nuk ka asnjë dëshmi për një shkelje të qëllimshme të të drejtave pronësore të shtetasve shqiptarë që i përkasin pakicës kombëtare greke.

KUSHTET E GREQISË

Megjithatë, komisioneri Hahn i ka kujtuar gjetjet e

NË FOTO: Komisioneri i Zgjerimit dhe Fqinjësisë, Johannes Hahn



Komisionit mbi pabarazitë në zbatimin e të drejtave pronësore në Shqipëri dhe procedurat për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, kthimeve dhe kompesimit të pronave që duhet të plotësohen nga autoritetet shqiptare.

Në reagimin e saj Ministria e Jashtme greke theksonte se rruga europiane e Shqipërisë kalon nga respektimi i të drejtave të minoritetit dhe se Tirana sipas saj nuk është e interesuar për integrimin në BE.

DIBËR

Arrestohen 3 persona për drogë e dhunë ndaj efektivëve

Tre persona janë arrestuar nga policia në kuadër të operacioneve për kapjen e personave në kërkim, të atyre që qarkullojnë me armë zjarri pa leje dhe atyre që mbajnë apo trafikojnë lëndë narkotike. Policia e Dibrës ka arrestuar në flagrancë Olsi Toska, 24 vjeç, Astrit Buci, 34 vjeç, dhe Altin Margjoka, 30 vjeç. Arrestimi i Astrit Bucit dhe Altin Margjokës është bërë për kundërshtim dhe goditje të punonjësit të policisë. Sipas informacioneve paraprake, në çastin e shoqërimi nga policia Astrit Buci ka goditur

punonjësit e policisë dhe më pas ka ndërhyrë shoku i tij Altin Margjoka, i cili ka goditur policët për mos shoqërimin e shokut të tij. Ndërsa Olsi Toska është arrestuar pasi në momentin kur policia ka shkuar për kontroll në banesën e dajës së tij Astrit Bucit, është kapur duke dalë me një kovë ku brenda saj kishte 0.5 kg lëndë narkotike, canabis sativa. Tre të arrestuarit do të përballen me akuzat “Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” dhe “Kundërshtim me dhunë i punonjësve të policisë”.



VLORE

I vendosi qëllimisht zjarrin një automjeti, pranga 24-vjeçarit

Një 24-vjeçar është arrestuar nga policia e Vlorës pasi i ka vendosur qëllimisht zjarrin një automjeti. Blutë bëjnë me dije se në pranga ka rënë 24-vjeçari Resul Zeqiri cili ka djegur pjesërisht një automjet tip Iveko me targa VI 1039 D në pronësi të E.S. Automjeti ka qënë i parkuar brenda një pikë grumbullimi të mbetjeve të riciklueshme, dhe ka qënë në përdorim nga punonjësit e kësaj firme. Lidhur me këtë rast policia nisi hetimin intensivisht për vënien përpara përgjegjësisë, shkakëtarin e zjarrvënies së qëllimshme të automjetit. Policia ka referuar materialet në Prokurori në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur për veprën penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal.



NGJARJA NË BERAT

Vdes në spital 49-vjeçari familjarët akuzojnë mjekët

Një 49-vjeçar ka ndëruar jetë në spitalin e Beratit, por familjarët e tij pretendojnë se i afërmi i tyre ka vdekur si pasojë e mjekimit të pakujdesshëm nga ana e mjekëve. Policia bën me dije se 49-vjeçari me inicialet T.M ka vdekur në spitalin e Beratit. Grupi hetimor kreu të gjitha veprimet hetimore dhe pritet akti i ekspertimit nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Berat, për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.



Berat, goditi infermierin në fytyrë procedohet penalisht 46 vjeçari

Një 46 vjeçar po procedohet në gjendje të lirë në Berat pasi ka goditur një infermier. Sipas policisë 46 vjeçari me inicialet A.V, ka goditur në fytyrë infermierin e turnit me inicialet A.K, 30 vjeç banues në Berat. Nuk dihen ende shkaqet që e kanë çuar 46-vjeçarin drejt këtij veprimi. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Berat, për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”.

NGJARJA SARANDË

Plagosi 35-vjeçarin gjykata lë në burg Renald Canaj

Renald Cena, i akuzuar për plagosjen e 35-vjeçarit Fisnik Musa, është lënë në burg nga Gjykata e Sarandës. Cena akuzohet për “plagosje me dashje”, “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, “prodhim e shitje e lëndëve narkotike”, dhe u kap në Fier pasi u largua nga vendngjarja. Ngjarja për të cilën akuzohet ndodhi disa ditë më parë më 29 gusht në shëtitoren e Sarandës, në një lokal nate ku tre persona u plagosën. 6 të rinj u konfliktuan me njëri-tjetrin dhe nga përplasja me armë mbetën të plagosur Besi Xhafaj 26 vjeç, Anton Shyti 37 vjeç dhe Fisnik Muca bashkëpronari i lokalit të natës. Renald Cena u arrestua, ndërsa vadojnë të jenë në kërkim dy personat me inicialet A.Q. dhe D.M.



8 vatra në 24 orë, vijon zjarri në Tarabosh e Bushat

Zjarrfikësi plagoset gjatë luftës me flakët, jashtë rrezikut për jetën

Nga 10 ka shkuar në 8 numri i vatrave brenda 24 orëve në disa qarqe të vendit. Në njoftimin për mediat bëhet me dije se në Malin e Taraboshit dhe në Bushat të Shkodrës vijnë të jenë aktive ende disa vatra zjarri. Edhe në Malin e Munellës në Pukë, vatra e zjarrit është ende aktive. Forca të bashkisë, të pyjores dhe banorë të zonës kanë punuar për të izoluar zjarret. Puna për shuarjen e tyre vazhdon ende me mjete rrethore për shkak të terrenit të thyer malor. Zjarrfikëset dhe forcat ushtarake të ndihmuar nga banorë të zonës kanë punuar

→ VATRAT

Nga 10 ka shkuar në 8 numri i vatrave brenda 24 orëve në disa qarqe të vendit. Në njoftimin për mediat bëhet me dije se në Malin e Taraboshit dhe në Bushat të Shkodrës vijnë të jenë aktive ende disa vatra zjarri.

gjatë gjithë ditës për të izoluar flakët. Rreth 30 forca ushtarake janë angazhuar ditën e djeshme për të shuar vatrën e mbetura. Në operacionin e djeshëm, një punonjës i shërbimit zjarrfikës të Shkodrës mbeti i plagosur dhe ndodhet

në spital, jashtë rrezikut për jetën. Në fshatin Bushat Shkodër, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe pisha pranë një ish-reparti ushtarak. Zjarri i favorizuar nga era preku një sipërfaqe të madhe. Forca të bashkisë, të pyjores dhe banorë të zonës kanë punuar për të izoluar zjarret. Puna për shuarjen e tyre vazhdon ende me mjete rrethore për shkak të terrenit të thyer malor. Edhe në qarkun e Lezhës vijon operacioni për shuarjen e një zjarri në një zonë malore në fshatin Lajthizë të Mirditës. Në fshatin Lurë Dibër, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe pisha. Për shkak të terrenit malor zjarrfikëset



nuk kanë mundur të ndërhyjnë. Mëngjesin e djeshëm në operacion janë angazhuar edhe 30 forca ushtarake.

NDËRHRYJA E ZJARRFIKËSVE NË KOHË

Në qytetin Laç, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me

shkurre dhe pisha pranë një ish-reparti ushtarak. Falë ndërhyrjes së menjëhershme të zjarrfikësve dhe forcave ushtarake është bërë e mundur që zjarri të shuhet plotësisht duke mos rrezikuar zonën e banuar. Në fshatin Roshnik Berat, ka rënë zjarr

në një sipërfaqe me shkurre dhe ullishte. Shërbimi zjarrfikës ka shkuar në vendngjarje dhe ka shuar flakët. Si pasojë e zjarrit u dogj një sipërfaqe prej rreth 3 dynym me shkurre dhe 40 rrënjë ulliri. Forca zjarrfikëse dhe ushtarake kanë punuar gjatë gjithë ditës së djeshme për të izoluar flakët, por për shkak të terrenit malor nuk kanë mundur t'i shuajnë plotësisht. 30 forca ushtarake janë duke operuar për të shuar vatrën e mbetura të zjarrit. Në hyrje të qytetit Poliçan, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me pisha. Pas ndërhyrjes së zjarrfikësve zjarri është shuar. Si pasojë u dogj një sipërfaqe e vogël me shkurre dhe disa pemë pishe.

TË DHËNAT

Emergjencat Civile bëjnë me dije se në operacione për shuarjen e zjarreve janë angazhuar 70 punonjës zjarrfikës, 14 automjete zjarrfikëse, 150 forca ushtarake, rreth 50 punonjës të Pyjores e të bashkive dhe vullnetarë, të mbështetur edhe nga helikopterë. Ndërsa, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, përsërit thirrjen ndaj të gjithë qytetarëve që në rast se konstatojnë zjarre, të njoftojnë menjëherë në numrat e emergjencave 112, 129 dhe 128.

BASHKIA E TIRANES

Nis rikonstruksioni i Bibliotekës nr.4 në Njësinë 9

Rikthimi i vëmendjes së të rinjve te leximi është një sfidë e gjithë shoqërisë

Të rinjtë, miq të librit dhe banorë të Njësisë Bashkiake nr. 9 në Tiranë, do të kenë së shpejti një ambient të ri dhe të denjë për të lexuar dhe zhvilluar aktivitete të ndryshme sociale e kulturore. Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj theksoi se investimi në kulturë është investimi më i mirë për të ardhmen e qytetit dhe shoqërisë. Ai nënvizoi se këtë vit do të përfundojnë tre biblioteka lagjesh, ndërsa është siguruar edhe një fond i pasur librash, të cilët do të shpërndahen në të gjitha bibliotekat, për të krijuar një lamirshmëri më të madhe titujsh për lexuesit. "Më vjen mirë që në një kohë shumë të shkurtër, pak ditë nga



fillimi i punës tek biblioteka "Musinë Kokalari", po nisim punë në bibliotekën e njësisë 9. Kjo është një punë në infrastrukturë, por është edhe një punë në kulturë. Përveç rinovimit të bibliotekave, kjo është e dyta, së shpejti do të kemi edhe një të tretë, kemi krijuar edhe një fond prej 10 mijë tituj librash, të cilët do furnizojnë bibliotekat e lagjeve dhe shkollave", tha

kryebashkiaku Veliaj. Ai u shpreh se rikthimi i vëmendjes së të rinjve te leximi është një sfidë e gjithë shoqërisë, por së pari e institucioneve shtetërore në një kohë kur teknologjia po fiton gjithnjë e më shumë terren. Biblioteka nr. 4 megjithëse nga më të frekuentuarat, ajo ishte në një gjendje të mjerueshme fizike, për shkak se prej vitësh nuk ishte bërë asnjë investim.

FIER

Zjarri në fshatin Peshtan djeg hektarë të tërë me pisha

Një zjarr i madh ka rënë rreth orës 13:00 të ditës së djeshme në fshatin Peshtan të Levanit duke djegur hektarë të tërë me pisha dhe shkurre. Në vendngjarje kanë shkuar forcat zjarrfikëse të Fierit, Patosit dhe forcat e avarisë së Albperolit. Zjarrfikësit po punojnë për shuarjen e flakëve, ku në disa vatra kanë hasur problem për të ndërhyrë për shkak të terrenit të vështirë. Në ndihmë të forcave zjarrfikëse ka shkuar dhe FNSH-ja e Fierit dhe pritet të shkojnë dhe forcat e ushtrisë. Sipas informacioneve të para zjarri filloi në tre vatra dhe më pas u shtri në gjithë masivin pyjor. Në vendngjarje për inspektim ka shkuar edhe prefekti i Fierit, Vaso Bregu. Në një prononcim për Report Tv prefekti Vaso Bregu shprehet se, "Zjarrfikësit po punojnë prej dy orësh për shuarjen e flakëve dhe kanë hasur vështirësi në disa vatra për shkak të terrenit të vështirë. Në ndihmë të Tyre ka ardhur FNSH-ja dhe pritet të vijnë dhe Forca të Ushtrisë". Pas 5 orësh përpjekje nga forcat zjarrfikëse të Fierit, Patosit dhe Albpetrolit, zjarri që përfshiu masivin pyjor në fshatin Peshtan të Levanit është shuar.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë agjent marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

PERSONAT E INTERESUAR TË DËRGOJNË CV E TYRE NË ADRESËN:
marketing@shqiptarja.com

TË KETË ARSIM TË LARTË
TË KETË PËRVOJË PUNE
TË JETË I GATSHËM PËR TË PUNUAR NË TERREN

Myftiu: Përpyjekje për të nxitur përçarje fetare

Ylli Gurra: Ekranet, jo për të mbuluar Monumentin; Ja kush më kërcënoi me jetë

Myftiu i Tiranës, Ylli Gurra pas reagimeve të shumta për mbulimin e monumentit të Skënderbeut në 'Sheshin Skënderbej' gjatë ceremonisë të festës së Kurban Bajramit ditën e premte, komenton në studion e Report Tv në emër të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Sipas tij, skenografia e ngritur në sheshin Skënderbej nuk kishte për qëllim të mbulonte monumentin e heroit kombëtar, por të përcillte mesazhe për të gjithë besimtarët e pranishëm në shesh. Gurra i cilëson histori kolektive akuzat në drejtim të organizatorëve dhe besimtarëve myslimanë, ndërsa thekson se ka përpyjekje nga brenda dhe jashtë për të cenuar harmoninë fetare në Shqipëri. "S'e përjashtoj mundësinë e një pjese, kushdo qofshin, brenda apo jashtë, janë përpyjekur t'i fryjnë kësaj, të një ndasie të momentit, si p.sh myslimanët paskan këtë qëndrim ndaj figurës së heroit kombëtar. Përkundrazi, s'ka asnjë arsye, Skënderbeu dhe të gjithë heronjtë kombëtar, figurat historike, që kanë vënë sakrificat e tyre për ngritjen e themeleve të shtetit, ka myslimanë, të krishterë, mbeten figurat më madhështore që ka ky komb më shumë se çdo komb tjetër". u shpreh Gurra. Ai sqaron gjithashtu se myslimanët nderojnë çdo figurë historike të kombit shqiptarë që ka vendosur përpara kombin dhe atdheun. "Skënderbeu ka qenë një moment historik domethënës për kombin shqiptar. Ne myslimanët e kemi kusht të patjetërsueshëm të kujtudo kohe, besimi që mbi gjakun e vet ka vendosur përpara kombin, atdheun". Myftiu i Tiranës flet edhe për kërcënimet me jetë në adresë të tij, ndërsa sqaron edhe arsyen pse nuk ka bërë denoncim në polici.

Z.Gurra, cili është komenti juaj lidhur me mbulimin me ekrane të mëdhenj të monumentit të Skënderbeut?

Si për çdo vit, organizimin e dy bajrameve, KMSH e ka bërë në hapësirat publike në bulevardin dëshmorët e kombit, dhe tashmë pas 9 vitesh, ritualet janë rikthyer në sheshin Skënderbej, ku falen besimtarët. Për dje, skenografia u përgatit nga vetë KMSH për përcjelljen e mesazheve dhe ritualit të momentit të faljes në orën 07:00 të mëngjesit dhe për të lehtësuar lidhjen e pjesës së besimtarëve me pjesën udhëheqëse të namazit, pasi është një hapësirë e madhe prej 25 mijë m² dhe vetëm përmes atyre ekraneve të mëdhenj mund të bëhej. Skena përbëhej nga dy ekrane të mëdhenj, njëri u flet zonjave besimtare, në të djathtë dhe në të majtë, është pjesa e besimtarëve.

Mund të vendoseshin në një pozicion tjetër ekranet?


Faktikisht në terren nuk kemi aspak një mbulim të monumentit të heroit tonë kombëtar. Nga skena ka një largësi 11 metra nga busti i heroit. Është e qartësuar dhe e dukshme që nuk ka një mbulim të bustit të heroit. Për shkak të hapësirës së sheshit, vendosjes së zonjave në të majtë, kërkohet edhe lartësia e ekranit dhe madhësia, në mënyrë që mesazhet të përcillen nga të gjithë. Po të shikoni sheshin,



Monumenti i Skënderbeut i mbuluar nga ekranet



(Në rreth) Ekranet para monumentit të Skënderbeut



Myftiu i Tiranës, Ylli Gurra

shtrirja e besimtarëve është nga Xhamia e At'hem Beut, pra nga monumenti i Skënderbeut e deri te Muzeu Kombëtar dhe Hotel Tirana. Kurrsesi nuk ka asnjë arsye, asnjë shkak që ne të shkonim drejt mbulimit të monumentit të heroit tonë kombëtar për faljen e Bajramit. Ne ishim aty në qershor, në Bajramin e Madh dhe nuk pati diçka të tillë. Edhe atëherë ka pasur ekrane, por më të vegjël. Ndërtimi i skenografisë ka qenë më në brendësi të sheshit, në drejtim me Bankën e Shqipërisë. Nuk ka non sens të mbulohej busti i heroit kombëtar që ka bërë historinë e këtij vendi. Ndoshta ajo pjesë e opinionit e ka parë nga një këndvështrim tjetër.

Pse ky reagim? A ka frymë të përçarjes fetare në Shqipëri?

Kjo nuk është një e rënë nga

Punimet

"Xhamia e madhe nuk hapet as për Bajramin tjetër"



Ndonëse të gjithë besimtarët myslimanë presin që Bajramin e ardhshëm ta festojnë te Xhamia e Madhe e Namazgjasë, Ylli Gurra ka një lajm jo të mirë. "As për Bajramin tjetër Xhamia e Namazgjasë nuk mund të përfundojë, nuk mund të jetë gati. Duhet më shumë se një vit. Pastaj, sipas kalendarit, kemi edhe një afrim të Bajramit për vitin e ardhshëm, në datën 12 ose 13 qershor, ndërsa Kurban Bajramin në datën 20 gusht. Xhamia nuk arrin dot të përfundojë, apo të dorëzohet në qershorin e vitit 2018. Pra, me 99% nuk është e mundur". Gurra thotë se objekti nuk do jetë gati as për vitin e ardhshëm, ndërsa kryebashkiaku Erion Veliaj, gjatë urimit për besimtarët myslimanë u shpreh se xhamia do të jetë gati. "Ju uroj të gjithëve Gëzuar Bajramin. Xhaminë do e hapim pas një viti dhe me në fund komuniteti mysliman i Tiranës do të ketë një hapësirë për besimtarët, por kjo xhami do të jetë hapësirë edhe për qytetin, do të ketë qendër kulturore, do të ketë muzeum më unik në Evropë të bashkëjetesës fetare dhe besoj se harmonia fetare nuk duhet marrësi e mirëqenë, por duhet të kurohet", deklaroi Veliaj.

qielli dhe gjithsecili korr frytet e saj. Harmonia dhe toleranca, bashkëpunimi e bashkëvëllazërimi fetar e kombëtar duhet ushqyer çdo ditë. S'e përjashtoj mundësinë e një pjese, kushdo qofshin, brenda apo jashtë, janë përpyjekur t'i fryjnë kësaj, të një ndasie të momentit, si p.sh myslimanët paskan këtë qëndrim ndaj figurës së heroit kombëtar. Përkundrazi, s'ka asnjë arsye, Skënderbeu dhe të gjithë heronjtë kombëtar, figurat historike, që kanë vënë sakrificat e tyre për ngritjen e themeleve të shtetit, ka myslimanë, të krishterë, mbeten figurat më madhështore që ka ky komb më shumë se çdo komb tjetër. Skënderbeu ka qenë një moment historik domethënës për kombin shqiptar. Ne myslimanët e kemi kusht të patjetërsueshëm të kujtudo kohe, besimi që mbi gjakun e vet ka vendosur përpara kombin, atdheun.

Dje përpara faljes së namazit keni marrë kërcënime. Nga kush vijnë?

Nuk do të isha në rrjedhën që mund të bënim furtunë në një gotë ujë, por ishin disa mesazhe të cilat kanë qenë të drejtpërdrejta, ekstremisht kërcënuese. Kam hedhur në rrjetet sociale urimin në orën 04:00 të mëngjesit dhe pas orës 09:00 të mëngjesit mesazhet kanë qenë kërcënuese. Personat me emra të rremë apo të qenë, janë të lehtë të verifikueshëm, nëse i drejtohem institucioneve. Por të ushqyer nga ajo për të ndjellë frikë, pasiguri e për t'i fryrë ndasie fetare, kanë vijuar me orë të tëra kërcënimet.

A keni bërë denoncim?

Ende nuk kam bërë denoncim. Kjo sepse nuk i shërben asgjëje. Nuk është e rëndomtë apo e rastësishme, sepse hera-herës në raste festash mund të hidhen shashka, kundërshtia apo komente, por kjo për fatin e keq ka marrë trajtën e një histerie. Kurrsesi, as në raport me figurën e heroit kombëtar dhe me asnjë figurë që ka ngritur kombin para vetes, myslimanët janë të parët që kanë detyrimin e lartësimit të përcjelljes në breza të këtyre figurave.

Kur pritet të përfundojë Xhamia e Namazgjasë? Do jetë gati për Bajramin e ardhshëm?

As për bajramin tjetër Xhamia e Namazgjasë nuk mund të përfundojë, nuk mund të jetë gati. Duhet më shumë se një vit. Pastaj, sipas kalendarit, kemi edhe një afrim të Bajramit për vitin e ardhshëm, në datën 12 ose 13 qershor, ndërsa Kurban Bajramin në datën 20 gusht. Xhamia nuk arrin dot të përfundojë, apo të dorëzohet në qershorin e vitit 2018. Pra, me 99% nuk është e mundur.

A mendoni se futja e fesë në shkolla do largonte dashakeqësitë fetare?

Jemi të bindur dhe kemi shprehur dakordësinë tonë që njohuritë fetare, ato të domosdoshme, nuk ka asgjë negative që të përcillen në shkollat publike. Nuk pritet që të dalin priftërinjtë apo hoxhallarët e radhës. Shoqëria ka nevojë për njohjen e brendisë shpirtërore të qytetarëve. Kjo është aq e nevojshme sa në harmoni të plotë dhe brenda kornizave ligjore të një shteti laik. Kemi shembuj si Britaninë e Madhe, Austrinë etj.



PERIFERI

NGA Alba MALLTEZI

Dokumentet e publikuara nga Shqiptarja.com janë dokumente zyrtare, të dhëna që ekzistojnë, por që fshihen nëpër zyra që vetëm një gazetar mund të ndjehet i interesuar, i detyruar për shkak të misionit e profesionit t'i marrë e të bëjë lajm

Dëshira për të vërtetën nuk ka vdekur

vijon nga faqja 1

Shqiptarja.com në print, përmes shkrimeve të gazetarit Adriatik Doçi, ku me dokumente tregoheshin pasuritë e njerëzve të drejtësisë, politikës etj. katërfishoi shpërndarjen. Është një tendencë që shkon kundër rrjedhjes së ngjarjeve, kur duket se gazeta, informacioni në print "kanë vdekur", dhe media në web, e sidomos rrjetet sociale kanë marrë dhenë me lloj lloj informacionesh e opinionesh. Fenomeni i gushtit të këtij viti na hedh në një refleksim, por edhe në një zbulim shpresëdhënës: Shqiptarët duan të informohen me sineritetet e profesionalizëm.

Në të vërtetë, shqetësimi i "dorëzimit" të një populli, humbja e dëshirës për t'u in-

formuar, është problem global. Përthithja e interesit dhe pjesës më të madhe të kohës nga ana e rrjeteve sociale, sikur ka hutuar lexuesit në përgjithësi, në mbarë botën.

Por ja që papritur, edhe në këtë vendin tonë të vogël, vijnë sinjale që duhet të dimë se si t'i lexojmë: Në këtë verë të nxehtë, bashkëatdhetarët tanë, kudo që janë, përgënjeshtruan tendencën që dukej si një rrugë pa kthim: mediat serioze tradicionale, gazetaria e fakteve, e lajmit të ofruar me profesionalizëm, seriozitet e përkushtim, është në zemrën e shumë njerëzve, kërkohet dhe dëshirohet prej tyre edhe në versionin e letrës.

Të gjithë jemi në një sulm të vazhdueshëm nga opinionet. Opinionet hidhen lehtësisht nga kushdo që këndvështrimin e tij mund ta bëjë publik nga një divan "Fendi", me qëllimin



për të dizinformuar, apo nga kush, në një minder, përpjetë të arrijë komoditetin "firmato" të fqinjit të tij. Për të mos folur për ata më të "sofistikuarit" në qëllime politike, ekonomike,

apo thjesht zillie. Po ata që me opinionin e tyre i shohin të gjithë nga lart-poshtë, sikur ç'kanë bërë vetë në jetë më mirë? Jemi në një overdozë opinionesh, që duket se nuk

do të zgjasë pa fund.

Dokumentet e publikuara nga Shqiptarja.com janë dokumente zyrtare, të dhëna që ekzistojnë, por që fshihen nëpër zyra që vetëm një gazetar

mund të ndjehet i interesuar, i detyruar për shkak të misionit e profesionit t'i marrë e të bëjë lajm. Gazetaria e vërtetë bën pikërisht këtë dhe prandaj ka një mision akoma më të rëndësishëm në amullinë e opinionëve, të bërtiturave, tymnajës së hedhur poshtë e lart: Të qartësojë, të ofrojë të vërtetën mbi të cilën pastaj, cilido ngre një opinion.

Në fillim të kësaj vjeshte, kur administratorë publikë e privatë vazhdojnë të vetëpërkrahohen bukur e mirë në rrjetet sociale, atëherë kur kanë lënë pas dore e jashtë informimit një pjesë të madhe të popullsisë që për shkak të moshës apo kushteve nuk janë në internet, ne të Shqiptarja.com morëm këtë sinjal: Në Shqipëri lexojnë dhe e duan të vërtetën ta shohin, ta prekin me dorë, pastaj për llafe e opinione... dihet. Kafenetë janë plot.

Kryeministri
TIRANE

Edi Rama: Në Francë për Shqipërinë që duam

Kryeministri Rama ka marrë pjesë në forumin "Global Positive Forum", të organizuar nga presidenti francez, Emmanuel Macron, ku u diskutua për zhvillimin ekonomik të vendeve në zhvillim. Rama foli në këtë forum dhe u shpreh se ka detyrën e vështirë të qeverisë Shqipërinë në një kohë të vështirë. Pas foru-

mit "Global Positive Forum", është shfaqur premiera e filmit "Tranzicion-Art dhe Pushtet në Shqipëri", në Qendrën George Pompidou", të cilën Kryeministri Rama na e sjell përmes një fotogalerie të Postuar në Facebook-un e tij. "Albumi i vizitës njëditore në Paris - Pritja e organizuar nga Presidenti Macron në nder të organizatorëve

e të folësve kryesorë në forumin "Global Positive Forum" - Momente nga zhvillimi i forumit të ideuar nga Jacques Attali dhe gjatë fjalimit mbi ekonominë e dijes dhe Europën e barabartë për fëmijët tanë - Në premierën e filmit "Tranzicion-Art dhe Pushtet në Shqipëri", shfaqur në Qendrën George Pompidou", shkruan Rama në facebook.



MEDIA BOTËRORE

'Financial Times' artikull për Bjeshkët e Namuna: Ecje në mal

Bukuritë e Shqipërisë janë të shumta, një vend i bekuar nga nëna natyrë, bukuritë për të cilat është shkruar e shkruhet pa fund. Këtë herë, "Financial Times", ka vënë theksin tek bukuritë e Bjeshkëve të Namuna. Martin Fletcher, shkruan se ishte pikërisht emri ai që e tërhoqi të vizitonte këtë vend që ndodhet në kufi me Shqipërinë dhe Kosovën. "Jeta baritore ka mbetur e pandryshuar pavarësisht trazirave politike që ka zg-



jatur me dekada dhe numrit të madh, gjithnjë e në rritje, të vizitorëve. Me dhimbje në këmbë, dhe mushkëritë që po shpërthenin, u ndalëm në majën shkëmbore të malit Gjeravica, malit më të lartë në Kosovës. Ishte një përpjekje që ia vlejti. Nga pikëpamja jonë prej 8714 metrave ne anketuam disa prej peizazheve më të egra, më mahnitëse dhe më së paku të prishura që kanë mbetur në Evropë. Nën qiellin e kaltër, dhe me ajër të pastër,

ne admironim majat dhe kurrizet, dhe luginat e gjelbra të pacenuara që shtriheshin në çdo drejtim. Asnjë ndërtesë i modeleve hekurudhore nuk do të mund të krijojnë peizazh aq epik. Kjo distancë e largët dhe misterioze malore, shumica e saj e arritshme vetëm në këmbë, ofron më shumë se bukurinë. Ajo strehon barinjte dhe kopetë e traditat e lashta baritore që ende nuk janë shkatërruar nga mekanizimi. Në fshatrat e izolu-

ara, gjurmët vazhdojnë të mbijetojnë nga një kod i sjelljes shekullore që kombinon ekstremet e dënimit dhe bujarisë. Ishte emri - Bjeshkët e Namuna - që së pari kapi vëmendjen time. Një kërkim në Google më tregoi se ato shtriheshin në kufijtë e Kosovës, Shqipërië e Malit të Zi", shkruan Fletcher. Më poshtë mund të shikoni xhirimet nga udhëtimi i Fletcherit dhe përshtypjet e tij për "Bjeshkët e Namuna". /koha.net

Merkel e favorizuar për mandatin e katërt si kancelare

Sondazhet e fundit tregojnë se një fitore e Shulcit ka shumë pak mundësi që të ndodhë

Lufta elektorale tani ka hyrë në fazën e saj të nxehët. Sot zhvillohet dueli televiziv mes Angela Merkelit dhe Martin Schulzit. Kancelarja nga kristiandemokratët dhe rivali i saj Martin Schulz nga socialdemokratët, në orën më të mirë të transmetimeve televizive 20:15 për 90 minuta do të debatohet në transmetim nga katër kanalet më të mëdha televizive. Një në dy gjermanë duan ta ndjekin këtë duel, konstatohet në sondazhin e institutit të demoskopisë Forsa. Në shumë media gjermane ky event i madh televiziv konsiderohet si shansi i fundit për Schulzin për ta kthyer situatën në favor të tij. Sidoqoftë shanset janë të vogla, sikurse rezultojnë nga hulumtimi i institutit të demoskopisë Infratest-Dimap për kanalin televiziv ARD, i cili ka pyetur me telefon rreth 1000 votues. Gati dy të tretat e shohin qysh tani Merkelin si fituese. Vetëm 17% kanë besim se Schulz do të dalë me rezultat më të mirë në votime. Madje edhe në radhët e simpatizantëve të socialdemokratëve Merkel kryeson. Edhe nga radhët e përkrahësve të partive të tjera - CDU, FDP, Të Gjellbërit, AfD dhe Të Majtët - shumica beson tek kancelarja. Për Schulzin ky sondazh nënkupton se dueli televiziv është një sfidë e vërtetë sportive. Edhe sa i përket pyetjes së dytë kyçe në sondazh, krahasimi direkt

mes Merkelit dhe Schulzit, kancelarja është në epërsi: një në dy votues do ta zgjidhte direkt atë. Ndërsa Schulzin një në katër. Lidhur me këtë pyetje, megjithatë, panorama është e ndryshme po të shohësh secilin kamp të përkrahësve. Një e treta e përkrahësve të socialdemokratëve do të zgjidhnin Schulzin. Edhe tek të Majtët Schulzi është më i preferuar se Merkel, por jo tek Të Gjellbërit. Sidoqoftë të dy kandidatët shënojnë humbje elektorale. Schulz arrin në vlerën më të ulët ndonjëherë të socialdemokratëve. Merkel humbet tetë përqind të pikëve dhe është mjaft larg kuotës së saj më të mirë me 57% në korrik të këtij viti. Me kë do të qeverisë Merkel, nëse bëhet sërish kancelare, gjë që me sa duket e dëshirojnë shumë zgjedhës? Hulumtimet e institutit



Angela Merkel dhe Martin Schulz

Infratest-Dimap nxjerrin në pah një spostim të dukshëm krahasuar me parashikimet në pranverë. Një koalicion mes kristiandemokratëve dhe liberalëve preferohet nga 7% më shumë se në prill. Ky koalicion preferohet edhe nga shumica e përkrahësve të këtyre partive: 77% në radhët e atyre të CDU/CSU-së dhe madje 89% nga ata të liberalëve. Po me 7% ka rënë preferenca edhe ndaj koalicionit të gjerë CDU/CSU dhe SPD - ndpëse ky koalicion në përgjithësi kryeson në sondazhe. Koalicioni më i diskutuar aktualisht në Berlin është ai mes CDU/CSU me ekologjistët dhe liberalët, pozitiv vlerësohet edhe një koalicion mes SPD-së dhe ekologjistëve e liberalëve, por për këtë fillimisht SPD-ja duhet të fitojë me Martin Schulzin, gjë që prej javësh nuk duket të jetë kështu.

MAQEDONI

Pritet nisja e debatit për zyrarizimin e gjuhës shqipe

Vetëm një muaj pas miratimit në Qeveri, ligji për përdorimin e gjuhëve në Maqedoni, pritet të nisë diskutimet e tij në Parlament. Ashtu siç bëri të ditur në atë kohë edhe Zv.Kryeministri Hazbi Lika, ligji do të shkonte me procedurë të përshpejtuar për diskutim në Parlament. Komisioni i Çështjeve Europiane u është drejtuar deputetëve për mbledhjen që është parashikuar të zhvillohet më datë 5 shtator, ora 10:00 dhe ku pikë e vetme e rendit të ditës është diskutimi i propozim-ligjit për përdorimin e gjuhëve. Por, ky projekt-ligj, i cili parashikon se veç gjuhës maqedonase, gjuhë zyrtare është dhe shqipja dhe alfabeti i saj, do të kalojë për diskutime edhe në komisione të tjera Parlamentare përpara se të votohet. Ashtu siç njoftoi Kryeministri Zoran Zaev nga Durrësi, pas miratimit në Parlament, ligji do të shkojë për mendim dhe në Komisionin e Venecias, edhe lidhur me dy pikat që nuk janë përfshirë në këtë projekt-ligj, ai për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit shqip në uniformat e ushtrisë dhe në kartmonedhat në Maqedoni.

DIPLOMACIA/ 19 ANËTARË TË STAFIT ME PROBLEME SHËNDETËSORE

SHBA konstaton sulm akustik ndaj ambasadës së vet në Havanë

Sulmi akustik ndaj stafit të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Kubë u raportua muajin e kaluar nga autoritetet amerikane. Fillimisht u mendua se incidentet kishin marrë fund shumë muaj më parë dhe Departamenti i Shtetit deklaroi se numri i anëtarëve të stafit që kishin raportuar probleme me shëndetin ishte 19. Por tashmë çështja është rikthyer në qendër të vëmendjes pasi sindikata që përfaqëson stafin diplomatik thotë se disa nga viktimat kanë pësuar dëme të rënda dhe disa madje kanë humbur përfundimisht dëgjimin. Personeli diplomatik amerikan dhe një shtetas kanadez filluan të vinin re simptomat nga fundi i vitit të kaluar. Nga ana e saj, qeveria kubaneze mohon çdo përfshirje në këto sulme dhe deklaroi se po heton ngjarjen. Sidoqoftë, në gusht qeveria amerikane reagoi duke dëbuar dy diplomatë kubanezë nga Uashingtoni. Autoritetet deklaruan atëherë se dëbimi vinte në shenjë proteste ndaj dështimit të autoriteteve kubaneze për të mbrojtur stafin diplomatik. Dyshohet që sulmet të jenë

kryer me pajisje sonike, që kanë lëshuar valë zanore të padëgjueshme, që mund të shkaktojnë humbjen e dëgjimit, raportojnë mediat amerikane. Ditën e premte, qeveria e Shteteve të Bashkuara konfirmoi se një incident i tillë kishte ndodhur edhe në muajin

gusht dhe se numri i anëtarëve të personelit që raportojnë probleme është rritur. "Nuk e përjashtojmë mundësinë që raste të reja të shfaqen, teksa mjekët tanë profesionistë po mbikëqyrin gjendjen shëndetësore të komunitetit diplomatik", ka deklaruar

zëdhënësja e Departamentit të Shtetit, Heather Nauert. Departamenti i Shtetit nuk ka fajësuar ende askënd për ngjarjet. Misioni i Shteteve të Bashkuara në Havana u rihap në formën e ambasadës në vitin 2015, pas 50 vitesh armiqësi mes dy vendeve.



Anulimi

SHBA, të huajt që s'u lejuan mund të aplikojnë për vizë

Personave që iu është mohuar hyrja në Shtetet e Bashkuara, për shkak të urdhrin të parë ekzekutiv të presidentit Donald Trump për kufizimin e udhëtimeve, tashmë mund të riaplikojnë për viza pas një marrëveshjeje ligjore të arritur në një gjykatë federale. Qeveria amerikane do t'i kontaktojë tashmë të gjithë individët e kthyer mbrapsht në kufi, si pasojë e atij urdhri që hyri në fuqi më 27 janar. Megjithatë, marrëveshja e re nuk garanton se aplikantët do të sigurojnë vizat e kërkuara. Trump nënkuptoi urdhrin për herë të parë në janar, për të penguar njerëzit nga 7 vende me shumicë myslimane që të hynin në Shtetet e Bashkuara. Një lëvizje që shkaktoi protesta masive dhe shumë sfida ligjore. Trump e mbrojti më vonë urdhrin e tij ekzekutiv, duke thënë se "nuk ishte për të përjashtuar myslimanët". Por, një javë pasi nisi implementimin, një gjykatës federal në Seattle e pezulloi atë në rang kombëtar, duke lejuar vizitorët e penguar të hynin në SHBA, deri në zgjidhjen e apelimit të administratës së Shtetësisë së Bardhë.



Rusia

Ministri Lavrov reagon kundër mbylljes së konsullatës

Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov ka deklaruar se vendi i tij "do t'u përgjigjet ashpër veprimeve që e dëmtojnë", duke iu referuar sanksioneve të reja të urdhëruara nga Shtetet e Bashkuara. Ruisë i është kërkuar të mbyllë konsullatën e saj në San Francisco, si dhe përfaqësitë diplomatike në Nju Jork dhe Uashington. Lëvizja e fundit e Amerikës erdhi pas reduktimit nga Moska të stafit diplomatik amerikan në Rusi, me plot 755 persona në muajin korrik. Por, Lavrov fajëson administratën "Obama" për nisjen e mosmarrëveshjeve diplomatike dhjetorin e vitit të kaluar. Ish-presidenti amerikan përjashtoi 35 diplomatë rusë, si dhe mbylli dy përfaqësi ruse, për shkak të aneksimit nga Moska të Gadishullit të Krimesë nga Ukraina. "Gjithçka nisi saktësisht me qëllimin për të minuar marrëdhëniet ruso-amerikane dhe për të penguar Trumpin të bëjë propozime konstruktive gjatë presidencës së tij", tha Lavrov. "U bë për t'ia bërë atij sa më të vështirë të ishte e mundur të implementonte premtimet e tij zgjedhore për normalizimin e marrëdhënieve me Rusinë", vijoi ai.

Panucci debuton me fitore, Shqipëri - Liechtenstein 2:0

Kuqezinjtë nuk shkëlqejnë, por dominojnë dhe fitojnë relativisht lehtë. Në vendin e tretë me 12 pikë


Christian Panucci nis me së miri aventurën në krye të pankinës kuqezi. Trajneri italian debutoi me fitore 2:0 ndaj Liechtenstein në "Elbasan Arena" sfidë e vlefshme për Grupin G të eliminatorëve për Kupën e Botës "Rusi 2018". Golat për kuqezinjtë erdhën nga Odise Roshi në minutën e 53' dhe Ansi Agolli 12 minuta nga fundi i takimit, pasi pjesa e parë u mbyll me rrjeta të paprekura. Mesfushori devijoi në rrjetë një top të gjuajtur fort nga Migjen Basha, ndërsa mbrojtësi dha spektakël në zonën e rreptësisë dhe përmes një gjuajtje me të djathtën mposhti portierin mik. Një fitore e vuajtur por tregtues i karakterit të fortë të kësaj skuadre që nuk dorëzohet kurrë, as ndaj ekipeve që e kthejnë këtë lojë në një betejë nervash mes sulmit dhe mbrojtjes bunker. Pas kësaj fitoreje, Shqipëria renditet në vendin e tretë me 12 pikë në 7 ndeshje të luajtura. Grupi kryesohet nga Spanja dhe Italia, të cilët do masin forcat në mbrëmje. Pas tre ditësh, kombëtarja shqiptare udhëton drejt Maqedonisë për sfidën e kthimit. Takimi i parë i luajtur në "Elbasan Arena" ka përfunduar 2:1 për Shqipërinë. Panucci e nisi



ndeshjen me një formacion sulmues por njëkohësisht edhe disi anormal. Lullaku në qendër të sulmit i mbështetur

nga dyshja Roshi-Grezda u vendosën në fazën e avancuar, ndërsa Mamushaj, Basha e Abrashi formuan treshen

e mesfushës me katërshen klasike Mavraj, Ajeti, Hysaj e Agolli në mbrojtje përpara Etrit Berishës. Pjesa e parë kaloi e gjitha nën dominimin e kuqezinjve, por pa asnjë rast konkret për shënim. Liechtenstein u "blindua" mirë në mbrojtje duke mos i lënë asnjë hapësirë kuqezinjve. Ekipi ynë këmbënguli shumë të çante nga krahu i djathtë nëpërmjet Roshit e Hysajt, por harkimet e tyre thyheshin me lehtësi nga miqtë. Pjesa e parë mbaroi pa gola dhe loja në të dytën vazhdoi me të njëjtin skenar, tanët në sulm miqtë në mbrojtje. Kuqezinjtë e ritën presionin dhe me pak fat gjetën golin e parë. Në të 53-ën, goditja e këndit e grushtuar nga portieri kundërshtar përfundoi në këmbët e Bashës që e kalibroi të djathtën drejt portës, ndërsa Roshi me një prekje magjike zhbllkoi ndeshjen. Një gol me shumë peshë që zhbllkoi këmbët dhe e ndihmoi Shqipërinë të përshkonte rrugën e saj. Epërsia vazhdoi dhe një periç e Agollit i mbylli llogaritë e ndeshjes. Super Ansi Agolli shënoi ndoshta golin më të bukur të karrierës së tij në të 78-ën. Cepi i majtë i Peter Jehle u gjet saktësisht nga kapiteni në ndeshjen e tij të 70-të me fanellën kuqezi. Panucci ndërhyri sërish në formacion me aktivizimin e Hykës, i cili zuri vendin e abrashit dhe mesfushori shtatshkurtër e bëri më të paparashikueshëm sulmin e Shqipërisë. Frymëzues i një aksioni perfekt vetëm tre minuta nga fundi lojtari i San Jose tregoi se kilometrat që nga Kontinenti Amerikan nuk e kanë lodhur. Nga e djathta e sulmit pas një aksioni personal dhuroi një top të artë për Lullakun që nuk arriti të trefishonte vetëm për çështje centimetrash. Një tjetër aksion në minutën e parë shtesë, s'ërih nga Hyka por këtë herë ishte portieri i Lihtenshtejnit që i mohoi golin personal. Kaq mjaftoi për të kompletuar një mbrëmje deri diku pozitive dhe tregues i një Shqipërie që ka hyrë në një epokë tjetër. Kombëtarja ngjitet në kuotën e 12 pikëve në Grupin G dhe përgatit e qetë udhëtimin drejt Strumicës fqinje për një nga ndeshjet më të rëndësishme të kësaj faze eliminatorë.



SKUADRA ND. F. B. H. GOLAT PIKËT

1. Spain	7	6	1	0	24:3	19
2. Italy	7	5	1	1	18:7	16
3. Shqipëri	7	4	0	3	9:8	12
4. Israel	7	3	0	4	9:13	9
5. FYR Macedonia	7	2	0	5	9:13	6
6. Liechtenstein	7	0	0	7	1:26	0

KREU I FSHF-SË

Duka: Duhet të ishim më aggressive, maksimumin me Maqedoninë

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka u shpreh i kënaqur me fitoren e pastër 2-0 ndaj Lihtenshtejnit, por tha se skuadra duhet të ishte treguar më agresive në fillimin e lojës. "Është fillim sezoni dhe ndaj një kundërshtari që mbyllet mbrapa bëhet mjaft e vështirë fitorja. Ne nuk jemi Spanja që të jemi mësuar me të tilla ndeshje dhe në përgjithësi duhet të jemi të kënaqur nga skuadra. Por për të qenë i sinqertë, do të doja agresivitet në minutat e para, por përfundimi ishte pozitiv

dhe nuk ke se çfarë të flasësh më", tha Duka. Presidenti i FSHF foli edhe për sfidën e 5 shtatorit ndaj Maqedonisë. Ai tha vlerësoi kundërshtarin e radhës, por ishte optimist kur tha se Kombëtarja do të kthehet me 3 pikë nga Strumica. "Maksimumin me Maqedoninë, vetëm 3 pikët synojmë. Do të shkojmë të luajmë futboll dhe nuk kanë vend diskutimet se ku luhet ndeshja. Kam besim se do të kthehemi me një rezultat pozitiv dhe pse është një kundërshtar shumë i vështirë", tha Duka.



GOLASHËNUESI

Odise Roshi: Falenderoj Panucci-n, i lumtur për golin

Odise Roshi ishte autor i golit që zhbllkoi rezultatin ndaj Lihtenshtejnit dhe për këtë u shpreh i lumtur pas ndeshjes, por tha se më rëndësi se goli ka fitorja e skuadrës. Roshi u shpreh se skuadra hasi vështirësi deri në momentin e shënimit të golit, ndërsa më pas gjithçka ishte më e lehtë pasi kundërshtari nuk po qëndronte më në mbrojtje. Ndërkohë, ai falenderoi edhe trajnerin Panucci për besimin e dhënë. "Futbolli pranon edhe stolin. Unë bëj punën time dhe më pas vendos trajneri. Falenderoj Panucci-n që isha në formacion", tha mesfushori kuqezi.



ISH-TRAJNERI

De Biasi komenton fitoren: Mund të shënohej edhe një gol

Në pankinën e Shqipërisë në suksesin ndaj Lihtenshtejnit ishte një trajner i ri, Christian Panucci, por Gianni De Biasi nuk mund të mungonte në këtë ndeshje dhe e ndoqi atë nga tribuna e "Elbasan Arenës". Ish-trajneri i Kombëtares sonë ishte i parë që komentoi suksesin e parë të Panucci-t. De Biasi me humor tha se Shqipëria mund të kishte shënuar me lehtësi edhe golin e tretë, pasi më herët kishte parashikuar rezultatin 3-0 në favor të kombëtares sonë. I pyetur se si u ndje teksa e ndoqi ndeshjen nga tribuna, De Biasi u shpreh se për të ishte një ndjesi krejtësisht tjetër. Gianni De Biasi u pyet edhe nëse i kishte dhënë këshilla Panucciit para ndeshjes. Ai tha se nuk e ka bërë diçka të tillë, ndërsa me shaka u shpreh se i kishte thënë të fitonte të gjitha ndeshjet.





Panucci: Nuk ka kohë për festë, vjen Maqedonia

“Lojtarët ishin shumë serioz, s’ishte e thjeshtë. Më pëlqen që debutova me fitore”

Christian Panucci, ka qenë i pari që është ndalur të flasë për mediat dhe është shprehur i lumtur për fitoren dhe ka theksuar se menjëherë do të ulet para televizorit për të parë kundërshtarët e ndeshjes së ardhshme, Maqedoninë. “Lojtarët ishin shumë serioz, nuk ishte e thjeshtë. Më pëlqen që debutova me fitore, natyrisht. E rëndësishme është të luajmë futboll dhe në fund të fitojmë.” I pyetur nëse do të ketë rota-

cion me kundërshtarin tjetër Panucci ka thënë se “Natyrisht diçka do të ndryshojmë për ndeshjen tjetër, duhet parë se sa do rikuperojnë disa nga futbollistët, por në ndeshjen kundër Maqedonisë vendosja në fushë do të jetë tjetër”. Më intereson vetëm Maqedonia, do iki pak më vonë për të parë këtë takim që ata do luajnë kundër Izraelit, ka thënë tekniku i ri duke lënë të kuptohet se festimet për të fillojnë pas ndeshjes Maqedi-Izrael. “Lojtarët u reguan

seriozë dhe të përqendruar. Ne nuk e patëm të lehtë, sepse vuajtëm ta gjenim golin dhe kjo na tensionoi disi. Megjithatë, skuadra u tregua e zonja dhe jam i kënaqur për rezultatin. Morëm atë që deshëm. Unë kam dëshirë që skuadra të luajë mirë futboll dhe nuk më pëlqen loja me topa të gjatë. Nuk kam dëshirë të luaj në atë formë. Kundër Maqedonisë do të ndryshojë diçka. Të shohim se çfarë do të ndryshojmë, por tani duhet të shijojmë këtë fitore”, u shpreh Panucci për RTSH.

GRUPI YNË

Spanja shkatërron Italisë, fiton edhe Maqedonia

Spanja shkatërron Italinë dhe blinda vendin e parë në Grupin G kualifikues të Botërorit 2018. Fitorja 3-0 në “Santiago Bernabeu” u vendos nga dy madrilenët: ylli i Realit, Isco me dy gola dhe Alvaro Morata, i rritur në këtë stadium. Isco zhbllkoi supersfidën pas 14 minutave lojë, pas ekzekutimit perfekt të një goditje dënimi, përballë së cilës Buffon nuk mund të bënte asgjë. 25-vjeçari realizoi edhe golin e dytë përpara pushimit ndërmjet pjesëve, ndërsa Italia ishte e shpërfytyruar në fushë. Për të mbyllur çdo diskutim mendoi Alvaro Morata në të 77-ën, vetëm pesë minuta pas aktivizimit nga stoli. Një triumf i madh për Spanjën, që me fitoren në duelin direkt “hipotekon” vendin e parë dhe biletën drejt

finaleve të Botërorit “Rusi 2018”. Për Italinë mbeti vetëm zhgënjimi për një kapitullim që sipas gjasave pritet ta detyrojë skuadrën e Venturës të luajë në fazën “play off”. Në ndeshjen tjetër të Grupit G, Maqedonia regjistroi një fitore befasuese në fushën e Izraelit. Asisti magjik i Enis Bardhit në të 73-ën, i shfrytëzuar maksimalisht nga kapiteni Goran Pandev. Izraeli në krizë të thellë rezultatesh dhe mes çështjen Zahavi, që hoqi shiritin e kapitenit, kompromenton garën për vendin e tretë. Në këtë aspekt, sukcesi i maqedonasve i shërben Kombëtares shqiptare. Por, që kuqezinjtë ti mbyllin kualifikueset pas shpinës së Spanjës dhe Italisë, nevojitet të marrin rezultat pozitiv më 5 Shtator në Strumicë.



Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Ja si mburren në rrjetet sociale fëmijët e pasanikëve shqiptarë
- Përfitoi dieta në çadër deputetja e PD: Mos u kthefsha më kurrë...
- Ja sa para morën deputetët e PD gjatë ngujimit në çadër
- VIDEO/Çifti Meta-Kryemadhi ia merr valles me Besin e Xhensilën
- Letra prekëse e djalit që babai i vrau të ëmën: Teta Fildez i thuaj mamit...
- Apeli për ndihmë: Nuk dua të kem fatin e gjyqtarës
- Beteja e Albulenës/560 vjet nga fitorja e pazakontë e Skënderbeut
- De Biasi surprizë Kombëtares në stërvitje, “Shqipëria fiton 3-0”
- Ekran para Skënderbeut kërcënohet myftiu i Tiranës
- Lojtari i kombëtares: Nuk e dija që isha shqiptar, u surprizova

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Ja sa para morën deputetët e PD gjatë ngujimit në çadër
- Myftiu i Tiranës, Gurra: Përpjekje për të nxitur përçarje fetare
- Ekran para Skënderbeut kërcënohet myftiu i Tiranës
- Aksioni kundër ‘bosëve’ të drogës Paloka: Rama s’gjen vrimë të futet
- Droga e kapur në Itali Basha: Rama mashtron ndërkombëtarët

VIDEOT MË TË KLIKUARA

Shqipëri-Lihtenshtein, debutimi i Panucci: Përqëndrim maksimal



Nis rikonstrukcioni Bibliotekës nr.4 në Njësinë 9 nga Bashkia e Tiranës

Akuzat ndaj vrasësit të gjyqtarës rrezikon burgim të përjetshëm




Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

Sa besim keni te Qeveria e re?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampioneve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



2.661 | 333 856
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

Naxhia

"Gjithmonë donte të më bënte qejfin. Dilte xhiro me djalin, dhe kur kthehej fshihte duart me fruta apo lule mbrapa, dhe më puthte. Ishte njeri i përsosur, dhe shumë i bukur, me sy të kaltra. Ndonjëherë i thoja, ti kot më more mua, je gjithë ky burrë, dhe më thoshte: 'Unë ty të kam shpirt!'"



Historia

Para dy vjetësh, burri i znj. Naxhies, z. Vath Dedej, ndërroi jetë pa zhurmë, vetëm duke i shtrënguar fort dorën së shoqes. Mungesën e tij, 76 vjeçarja e ndjen çdo ditë, në çdo cep të shtëpisë së saj të vogël, ku tashmë jeton me djalin e dytë, i cili ka lindur me sindromën Down. Sot, djali i znj. Naxhie, z. Fatbardh Dedej është 56 vjeç.

Nëna e vetme në shtëpi me djalin 56 vjeçar, të prekur nga sindroma down

KRISTI GONGO
TIRANE

76 vjeçarja pas vdekjes së bashkëshortit, përballon e vetme vështirësitë e shtuara krahas djalit të saj me aftësi të kufizuara

Orët e para të ditëve monotone, të cilave u dihet filli e mbingarkesa, të marrin forcën ndonjëherë. Kësisoj, edhe një fjalë shprese që mund të gjendet me ne në mëngjes, vritet gjatë ditës dhe vdes ngadalë në errësirë. Kjo panoramë bëhet edhe më e shpeshtë a e zakonshme, kur njeriu e ka humbur gjysmën e zemrës në pleqëri, e patjetër që do t'i dalin lot prej gjysmës së mbetur; kjo ndodh me 76 vjeçaren, nënë Naxhie Dedej, të cilën e kam përballë vetes në një kafene të rëndomtë lagjeje, Atë, djalin e saj të përhumbur dhe historinë e një jete të mundimshme e të lodhshme, e cila, siç thotë nënë Naxhia "po mbërrin në fund të shkallëve". Para dy vjetësh, kur sapo kishin kaluar pak orë nga Viti i Vjetër dhe pasi kishin konsumuar darkën e Vitit të Ri 2015, në atmosferën e qiellit të flakëruar nga fishekzjarret, burri i znj. Naxhies, z. Vath Dedej, ndërroi jetë pa zhurmë, vetëm duke i shtrënguar fort dorën së shoqes. Mungesën e tij, 76 vjeçarja e ndjen çdo ditë, në çdo cep të shtëpisë së saj të vogël, ku tashmë jeton me djalin e dytë, i cili ka lindur me sindromën Down. Sot, djali i znj. Naxhie, z. Fatbardh Dedej është 56 vjeç. Por, ai do kujdesin e njëjtë si me të një fëmijë.

PAS VDEKJES TË SË SHOQIT

Dhe tanimë që z. Vath nuk jeton më, përveç dhimbjes të të birit dhe znj. Naxhie, përgjegjësia e kësaj të



fundit është dyfishuar.

Të dy flenë në një dhomë, ndonjëherë nënë Naxhia edhe e përkund kur Bardhi nuk ka gjumë; më pas kur dita agon, ajo bën gati mëngjesin dhe e ushqen, përafërsisht rreth dy orë; dhe mandej për orë e orë të tëra, të dy flasin me një gjuhë të përbashkët që u përket vetëm atyre, dhe kujtojnë kohët kur jetonin të tre. "Gjithmonë donte të më bënte qejfin. Dilte xhiro me djalin, dhe kur kthehej fshihte duart me fruta apo lule mbrapa, dhe më puthte. Ishte njeri i përsosur, dhe shumë i bukur, me sy të kaltra. Ndonjëherë i thoja, ti kot më more mua, je gjithë ky burrë, dhe më

Dhurata

E veshur me rroba të zeza, në qafën e znj. Naxhia bie në sy varësja e floririt me mbishkrimin 'Unë dhe Ti'. E pyetur se kush ja ka dhuruar, mes lotësh tregon se ia ka blerë z. Vath për 40 vjetorin e ditëlindjes.


thoshte: 'Unë ty të kam shpirt!'", tregon e përmalluar për Shqiptarja.com, nënë Naxhia. Ndërsa Bardhi vetëm dëgjon, në pamje të parë duket i shpërqendruar, por kur bie qetësia dhe asnjë nga ne nuk flet, dëgjohej nofulla e tij teksa kërcet. Naxhia rrëfen se marrëdhënia baba-bir ka qenë shumë e ngushtë e shoqërore; i shoqi kujdesej më shumë se ajo vetë për Bardhin, nuk mërzohej dhe nuk nxehej asnjëherë, ndërsa sot... në të dy shpirtat e tyre, është një vend bosh. Me vete në kafene, duart e nënë Naxhies mbanin një tullumbace - kapriçoja më e fundit e Bardhit - ndërsa ajo

tregon për Shqiptarja.com se dëshirat e tij janë të ndryshme nga dita në ditë. "Kërkon të blejë akulllore, dhe në fund nuk e ha, por lekë janë ato", shpjegon nëna, e cila shton se ja del të përballojë jetën vetëm me pensionin e saj dhe një ndihmë të papërfillshme nga shteti për Bardhin. Ndër të tjera, për shkak të moshës, ajo ka probleme me zemrën dhe ndaj është e detyruar të blejë ilaçe për vete dhe për djalin medoemos. Me këto vështirësi, ditët e tyre rrjedhin njësoj.

MARRËDHËNIA ME TË TJERËT

Naxhia tregon për Shqiptarja.com se që pas vdekjes së burrit, ajo nuk del më larg se disa hapa jashtë shtëpisë së saj. Pavarësisht se ka 5 fëmijë, 2 vajza edhe 2 djem të tjerë përveç Bardhit, Naxhia shprehet se ata janë martuar dhe secili ka problemet e tij. "Bëhen gati 3 vjet që nuk dal tek njerëzit, apo të flas me njeri këtu në lagje veç djalit. Edhe fëmijët e tjerë vijnë të më shikojnë se unë nuk kam dëshirë të dal më, por secili ka problemet e tij. Unë jam e lumtur se i rrita, e janë bërë fëmijë të mbarë, pavarësisht të gjithave: Jeta është luftë", rrëfen nënë Naxhia për Shqiptarja.com. Megjithatë raporti i fëmijëve të tjerë me vëllain e tyre, i cili është ndryshe nga ta, është i mirë, Naxhia thotë se e duan Bardhin. I vetmi problem janë njerëzit e tjerë, të cilët nuk e kanë pranuar. E veshur me rroba të zeza, në qafën e znj. Naxhia bie në sy varësja e floririt me mbishkrimin 'Unë dhe Ti'; e pyetur se kush ja ka dhuruar, mes lotësh tregon se ia ka blerë z. Vath. "Ma ka dhuruar njeriu im i zemrës kur festova 40 vjeç, edhe nuk e kam hequr kurrë!".

Andrea Skanjeti, Regjisori që i dha dritën e zemrës teatrit



Gaqo Spiru, Aktori durrsak që u dha jetë dhjetra roleve krah yjeve të teatrit e filmit

Në lagjen e vjetër "Varosh" të qytetit të Durrësit, e cila njihej vitet e pasçlirimit në ndarjet e reja administrative si lagja nr 11, kalonte çdo ditë një personazh interesant, banor i kësaj lagjeje. Ishte Gaqo Spiru. Përhëndeste të njohur, por edhe u kthente me mirësjellje përhëndetjet të panjohurve që e salutnin. Dhe kjo kategori ishte e shumtë. Pasi shumë prej tyre nuk e dinin se ku punonte,....

NGA **MARK BRUNGA**

faqe 20-21



Në Majestiku... Kinemaja, ku thureshin ëndrra me Çaplin e Greta Garbo

Nuk e kam vrarë mendjen ndonjëherë, se si ishte sheshi i vogël para kinemasë, para se të ndërtohej "Majestiku". Besoj se duhet të ketë pasur banesa të vogla një dhe dykatëshe. I gjithë kompleksi, duke përfshirë "Bar Republikën" ishte ndërtuar më mirë, se gjithë ndërtimet përreth. Prej ndërtimit ka "sunduar" formulimin arkitekturore të atij sheshi. Kishte qënë meritë e projektuesve,....

NGA **NAUM MARA**

faqe 22

NGA **XHAHID BUSHATI**

Në vend të hyrjes kjo Përcjellje... Shënime dhe skeda pafund... kam për Andrea Skanjetin.

Andrea Skanjeti: Drejtor, regjisor, autor (dramaturg), përkthyes, shkrimtar, filatelist (1), përgatitës fjalori, ...

Për jetën e tij poliedrike, që ia falit artit dhe teatrit, çdo ditë shënime dhe skedat më shtohen... Ndaj, dhe unë po përpiqem t'u njoh me disa prej tyre, duke u kërkuar falje të tjerave e për t'iu thënë se nuk iu kam harruar... Kohë pas kohe

do të ndiejmë dritësimin tuaj...

Andrea Skanjeti si regjisor, ishte i pari që çeli siparin e teatrit "Migjeni" të Shkodrës, jo vetëm për të bërë histori, por këtij Institucioni me traditë në Shkodër, me talentin e dijet e tij i vuri themele (në nëntor 1949) të sigurt jetëgjatësie dhe vazhdimësie në kohë dhe në hapësirë. Nderim Mjeshtër Andrea!

Studiuesi Josif Papagjoni duke studiuar këtë figurë në shumë rrafshet përmend se "Regjisura e tij ka qënë e pastër dhe disi e përkorë në formën e saj, me një koncept të qartë, ku binte në sy kultura,

njohja e thelluar e veprës, e shkrimtarit, e stilit, e kohës. Në artin e tij hasen parapëlqimet ndaj një gjuhe rëndom epiko-dramatike, por jo edhe pa praninë e një suaze historike dhe etnografike në përshkrimin e mjediseve, në kostumografi etj. Me dijet dhe njohuritë e tij profesionale ndikoi në mënyrë të ndjeshme në ngritjen kulturore artistike të trupës së aktorëve të teatrit duke zbatuar parime estetike të shkollave teatrore bashkëkohore."

vijon në faqet 16-19

■ **Vitet e fëmijërisë /** Kur Skanjeti luante teatër me shokët në ahurin e shtëpisë

■ **Kontributi i regjisorit /** Ai ishte i pari që çeli siparin e teatrit "Migjeni" të Shkodrës

PORTRET | ARTISTI



Andrea Skanjeti

Regjisori që i dha dritën e zemrës teatrit

NGA XHAHID BUSHATI

vijon nga faqja 15

...E kjo dritë, që e ka një emër dhe një mbiemër e, që quhet: Andrea Skanjeti, i cili i dha dritën e zemrës teatrit të Vendlindjes së tij për ta bërë të pavdekshëm duke i falur Epokë, autoktoni, origjinalitet, traditë e bashkëkohësi, të cilat lidhen me Mjeshtërinë e Regjisorit, Mjeshtri që kërkon përvulje dhe respekt. Dhe çuditërisht këtij njeriu të Madh, ndoshta është paradoks, një ditë para vdekjes, pikërisht më 28 nëntor 1992 iu dha titulli "Artist i Popullit".

2.

Skeda e parë: Shkodra, Gjyshi, Baba, Nëna dhe emri i tij...

Gjyshi i tij Andrea e përshkruan kështu Shkodrën, kur erdhi të banojë: "Shkodra... kishte pamjen e një qyteti oriental, me rrugët e ngushta të veshura me mure të larta ku spikatnin dyer të mëdha karakteristike, me pazarin oriental larg qytetit, me shtëpitë njëkatëshe me çardaqe e ahure, me oborre plot limonj, portokalle e lule të ndryshme ku zotëronte karafili."

Gjyshi i tij Andrea u martua me Tonen e Arsen Idromenos, motrën e piktorit Kolë Idromeno. Piktori përjetësoi motrën e vet në portretin që sot quhet "Motra Tone". (Për piktorin, - regjisori Skanjeti, - do të shprehej më vonë kështu: "Punoi mjaft skena për teatër, sidomos për Shoqërinë "Bogdani" e jezuitët. Bënte fondale e sipare me vlera artistike. Për shembull, sipari i Teatrit "Bogdani" paraqiste pamjen e Rozafatit, ditën e ngritjes së flamurit. Ishte trupmadh, shtatlartë, me fytyrë tërheqëse ngjyrë gruri, të përshkruar nga rrudha të thella si të prera me thikë, nën hijen e vetullave të trasha, sytë e tij plot dritë zgjuarsie, shprehnin diçka të butë, të përmallshme, të paarrirë. Mustaqet e prera shkurt qëndronin burrërisht mbi gojën e vogël. Nga martesa duke mos patur fëmijë (një djalë i pat vdekur që foshnjë) adhuroi fëmijët e të tjerëve.

Gjyshi i tij Andrea vdiq më 1908. I çmuar dhe i nderuar nga shkodranët. Regjisorin e la dy vjeç. I fali emrin e vet. Për babain, Zefin, ka kujtimet më të mira të jetës së tij. Andrea do ta portretizonte kështu: "Burrë simpatik dhe i hijshëm, trupmadh dhe i plotë, fytyrëqeshur, por edhe me pamje serioze, me atë mjekrën e vogël e mustaqet e shkurtra, që i ka mbaj-

Në nderim të regjisorit të parë, Artistit të Popullit Andrea Skanjeti (20 korrik 1906 – 29 nëntor 1992) ... Ai ishte i pari që çeli siparin e teatrit "Migjeni" të Shkodrës, jo vetëm për të bërë histori, por këtij Institucioni me traditë në Shkodër, me talentin e dijet e tij i vuri themele (në nëntor 1949) të sigurt jetëgjatësie dhe vazhdimësie në kohë dhe në hapësirë

tur edhe të thinjur, deri në vdekje." Ndërsa për nënën, Elizën, dashuria do të qëndrojë në këto rreshta: "Nëna ime, Eliza, gjithë jetën e kujdesin e saj të madh, na e kushtoi ne, fëmijëve. Ishte e edukuar dhe e kulturuar. Jetoj në një mjedis, ku breneveku dhe çarçafi njihej dhe çmohej si folklor."

3.

Skeda e dytë: Në Gjymnaz, dhe nëpër vite...

Kur ishte në moshën e gjimnazit, Andrea bëri përpjekje për të shkruar një dramë..., por pa sukses. Megjithatë teatrin nuk e la pas dore. Me këmbënguljen që e karakterizonte, ndjek shfaqjet e Shoqërive "Vllaznia", "Bogdani" dhe të Shkollës së Murgeshave Stigmatine. Në këtë periudhë merr pjesë në shfaqjet e Kolegjit si figurant, në dramat "Llogoret e mullinjve", "Konto Kavallo", etj., dhe si këngëtarë ndër akademitë

muzikore.

Në vitin 1915 nis veprimtarinë Shoqëria "Një tubë djelmni shkodrane". Qëllimi i kësaj shoqërie ishte: Bashkim e veprimtari patriotike. Si kryetar njihej Kel Marubi e kryetar nderi ishte Luigj Gurakuqi. Kjo Shoqëri, në ato rrethana kohe, u bë protagonistja e të gjitha manifestimeve politike të asaj kohe për çështjen kombëtare dhe organizuese e kremtimeve të 28 nëntorit.

Në atë kohë Andrea me familje banonte në rrugëzën përballë kino-teatrit e quajtur e shkollës së Parrucës. Si fëmijë ndiqte provat dhe shfaqjet që jepeshin aty, sidomos nga Shoqëria "Vllaznia". Në revistën "Agimi", Nr.1, maj 1919 lexojmë: "... më 16 shkurt 1919 anëtarët e Shoqërisë "Mustafa Pasha" e përbërë thjeshtë nga muhamedanë e "Vaso Pasha" e përbërë thjeshtë nga kristianë formuan Shoqërinë "Vllaznia" me





bashkimin e dy elementeve që t'u merreshin me politike drejtpërdrejtë dhe të zhvillonin aktivitet artistik-kultural me anë të rretheve e degëve muzikore-teatrore-letrare. Kjo që e para Shoqëri në Shkodër, pas Pavarësisë, me element laik të bashkuar."

"Shërbëtori i dy zotërve", është pjesa e parë që shfaq "Vllaznia". Komedia me tre akte e Goldonit u adaptua nga Hil Mosi vetëm për meshkuj. Premiera u dha më 28,

29.06.1919. Vetë Hila luajti rolin e Filip Bajunit, njërin nga zotërinjtë, ndërsa zotërinjtë tjetër herë e luajti Thanas Eftimi e herë e luajti Kolë Gurakuqi. Personazhin e shërbëtorit Tafrrukun e interpretoi Gjon Krajni, ndërsa shërbëtorin tjetër Jonuz Tafilaj, Tefë Leka – kamarierin, Ali Borshi – hamallin, Lin Deda – hotelierin, sufler është Karl Gurakuqi.

Më pas, më 01.01.1923 u themelua Shoqëria letrare që u quajt

"Jehona" nga pesë gjimnazistë: Gjergj Ashta Injac Saraçi, Pashko Kovaçi, Nush Gjonej, Andrea Skanjeti. Më vonë rrethi u zgjerua me Nush Sheldia, Gazpër Ljarja, Kel Abati, Lukë Mosi, Zef Serreqi, Fahri Dabulla, Lec Ndreka, etj. Qëllimi i kësaj Shoqërie ishte zhvillimi dhe lëvrimi i letërsisë duke përgatitur për botim tregime e përralla, duke mbajtur konferenca me përmbajtje shoqërore-edukative për nxënësit e shkollave, si dhe duke shkruar e vënë në skenë vepra teatrore e të përkthyer.

Gjatë kësaj kohe, në Gjimnazin Franceskan, Andrea nuk shkëputet nga veprimtaria teatrore. E thellon, e zgjeron, duke marrë pjesë në Shoqërinë "Gjon Krajni me shokë", duke ndihmuar me reperitor e drejtim grupin e Shoqërisë "Shkodra".

Fill pas mbylljes së shkollave private, në gjirin e franceskanëve, nga një tufë nxënësish të kësaj shkolle u themelua në vitin 1933 Shoqëria "Antoniane". Në fillim e përbërë nga gjimnazistë, zejtarë e punëtorë që morën pjesë në veprimtari të ndryshme si: sport, muzikë e veçanërisht teatër. Banda muzikore, që më parë ishte e shkollës, tani u mbajt nga Shoqëria "Antoniane". Anëtarët e degës teatrore që figurojnë në regjistrat e kësaj Shoqërie janë: Ndoc Harapi, Injac Ndoja, Ndoc Gora (- më vonë sufler në Teatrin Popullor, - shënimi im Xh. B.), Ndreka Shkejzi (më vonë aktor, - shënimi im Xh. B.), Lin Gjonej, Paulin Sekuj (më vonë regjisor në teatrin "Migjeni", - shënimi im Xh. B.), Lec Sekuj (më vonë mësuesi im i Gjuhës shqipe, - shënimi im Xh. B.), Gjon Karma, (më vonë aktor dhe historian teatri, - shënimi im Xh. B.), Pjetër Gjoka (më vonë aktor teatri dhe filmi, - shënimi im Xh. B.), Marian Skanjeti (i vëllai i Andrea Skanjetit, - shënimi im Xh. B.), Prenkë Jakova (kompozitor i shquar, - shënimi im Xh. B.), Pjerin Bushati, Prenkë Kçira, Ndoc Sheldia (më vonë aktor i teatrit të Shkodrës, - shënimi im Xh. B.), Pistol Soja (më vonë aktor i teatrit të Shkodrës, - shënimi im Xh. B.), Dedë Nikaj, Nikë Daka, Pashko Gjeçi (më vonë përkthyer i shquar, - shënimi im Xh. B.), Zef Mjeda (më vonë Kryetar i Shoqërisë "Bogdani", - shënimi im Xh. B.), Zef Marashi, Shan Zadrima, Gaspër Bicaj, Mati Shiroka, Çesk Vuksani (më vonë scenograf i teatrit të Shkodrës, - shënimi im Xh. B.), Lec Fishta (më vonë scenograf i teatrit të Shkodrës, - shënimi im

Xh. B.), Rrok Sheldia, Lec Simoni, Tom Leci, Pjerin Ashiku (kompozitor i shquar, - shënimi im Xh. B.), Lush Radoja, Simon Radoja, Luigj Gjyshja, etj.

Teatri i Shkollës Stigmatine zgjati tri dekada. Në vitin 1914 shfaqti dramën "Prej robnie në liri", një vepër e përkthyer nga gjuha italiane. Në këtë premierë deputuan nxënëset: Pina Pistulli, Lezina Muzhani, Liza Pema, Liza Fishta, Roza Shiroka.

Ndërsa Shoqëria "Rozafa" u themelua më 13.02.1918 dhe zgjati deri më 04.10.1939. Më e vjetra Shoqëri e qytetit, e me qëndrim jete më të gjatë. Themeluesit e saj janë: Simon Gurakuqi këpucar, Kel Luka komisioner, Cin e Nush Daija marangozë, Gegë Gurakuqi nëpunës, Shuk Paloka këpucar, Tonin Dajçi berber, Luigj Dajçi mekanik, Gjon Lacaj rrobaqepës, Kolë Kosmaçi.

Kurse Shoqëria "Bogdani" do të kishte këta themelues: Luigj Mjeda, Luigj Thaçi, Shtjefën Çefa, Ndoc Vasia, Rrok Zadeja, Kolë Harapi, Nush Paci, Kolë Guga, Kolë Shiroka, Ndoc Guga, etj., dhe pak më vonë Zef Harapi, Cin Çapeli, Kolë Dema, Zef Kovaçi, Ndoc Prendushi, Ndoc Nushi, Loro Kovaçi, etj.

Kështu përmes viteve të jetës së Andreas, çdo shoqëri me tiparet e karakteristikat e veta lanë gjurmë në veprimtarinë e tij të mëvonëshme artistike. Vërtetë do ta priste skena teatrore... Kështu, brenda një kohe relativisht të shkurtër Andrea shkroi dramën në 5 akte "Ali Pashë Tepelena dhe suljotët". Rolin e Ali Pashait mendoj t'ia jepte aktorit të ri Kolë Jakova, Ndoc Bazhdari do të mishërojë personazhin e këshilltarit të pashait, për Mark Zhavellën u vendos aktori i mirënjohur Ndoc Mëshkalla, për Foto Zhavellën kishte shënuar Gjergj Deli Çamukun, nuk do të harronte dhe Ndoc Temalin rrobaqepës, aktor i vjetër i Shoqërisë "Vllaznia" dhe i Teatrit "Shkodra", të cilin e angazhuan për qepjen e afër 40 kostumeve të dramës.

Pas suksesit të dramës në fjalë, "Vllaznia" vuri në skenë "Ëndrra e 500 vjetëve", me po të njëjtin autor, i cili ndërkohë dorëzon për botim pjesën komike me titull: "Kush e kërkon, e gjen", në redaksinë e revistës "Cirka".

Në vitin 1938 përkthen dhe vë në skenë dramën "Mortja e mesnatës", komedinë me një akt "Dy të burgosurit", boton 5 tregime

te revista "Hylli i Dritës". (Tregimi i fundit "Dhurata e papritur" botohet shqip dhe gjermanisht në librin "Shqipëria rrëfen" shkruar nga Maksimilian Lambertz).

Këtyre viteve u përkasin dramat "Fshehtësia e zarfit të kaltër", "Legjonarët"; opereta "Festa e Lilave", komedia "Felcigeni" (përkthim e adaptim).

4.

Skeda e tretë: Me horizonte të reja mendimi...

Pas një specializimi që Andrea bën në Tiranë, në dosjen e tij gjejmë edhe këto shënime (kujtime): (Naim Frashëri, Artist i Popullit: "Megjithëse ka qenë një kohë e shkurtër qëndrimi i tij pranë nesh, kemi arritur deri diku ta njohim njëri-tjetrin. U ambientuam shpejt me ju. Ndoshta është mjeshtria jonë e tillë.", (Kadri Roshi, Artist i Popullit: "Megjithëse të njohim prej një kohe të shkurtër, dashuria që kemi patur për njëri-tjetrin, bën që të mos ju harroj kurrë..."), (Mihal Popi, Artist i Popullit la këtë shënim: "Shokut tim, Andrea Skanjetit i uroj suksese në punë dhe dëshiroj që punën ta vazhdojë me dëshirë dhe vullnet!").

Me horizonte të reja mendimi, me projekte të reja skene vjen në qytetin e tij të lindjes, regjisor i ri Skanjeti. Me grupin qendror të teatrit të Shtëpisë së Kulturës vë në skenë pjesën melodramatike "Dasma", të cilën është edhe autor, e, që u ndoq nga një publik i gjerë dhe shënoi një sukses të madh për atë kohë. Gjithashtu vë në skenë: "Nën gështenjat e Pragës", "Fejsa", "Kaçusha", "Udhëtimi i madh".

Periodha 1946-1949 është me aktivitet të dendur dramatik e me suksese të njëpasnjëshme, e, që përgatitën rrugën e krijimit të teatrit profesionist në qytetin, ku regjisor i Skanjeti do të shpaloste mjeshtrinë autoriale dhe regjisoriale.

Tani sezoni 1951-1952 e gjen teatrin "Migjeni" në rrugën e artit skenik në mënyrë të kënaqshme profesionale. Por... Andrea, në vitin 1952, do të kthehet përsëri në Shtëpinë e Kulturës, në "folezën" e tij të njohur e të dashur. Vë në skenë operën "Mrika", libreti poeti Lllazar Siliqi, muzika Artisti i Popullit Prenkë Jakova. Për këtë ngjarje, Andrea do të thoshte: "Të vë në skenë një opera, për mua ishte një dëshirë e shumëvjetshme, dhe puna skenike më erdhi aq këndshëm dhe e lehtë, sikur asnjëherë tjetër duke vënë në skenë pjesë teatrore deri atëherë." Viti 1958 shënon një ngjarje të rëndësishme për jetën artistike të qytetit të Shkodrës, inagurohet teatri i ri. (Teatri "Migjeni" i Shkodrës, një ndër teatrot më të mira të vendit tonë, ruan traditën më të shëndoshë të shoqërive teatrore të kohëve të kaluara, traditë kjo që ka qenë e vjetër në qytetin e Shkodrës dhe që filloi me vitin 1880. U aprovuan: Andrea Skanjeti regjisor e drejtor, aktorët: Adem Kastrati, Antoneta Fishta, Ndreka Pella, Çezarina Çiftja, Ndoc Deda, Paulin Lacaj, Vitore Ujka, Tef Kroqi, në administratë: Zef Jubani llogaritar, Palok Kurti sufler, Pjetër Deda scenograf, Engjell Gjushi rrobaqepës, Lec Prendi marangoz; aktorë gjysmëprofesionistë me një shpërblim mujor u aprovuan: Zef Jubani, Tinka Kurti, Çesk Vuksani, Qazim Lila, Lin Gjonej, Gjovalin Çarkaxhia, Cin Lufi, Mark Bushati, Muhamet Ulqinaku, Halim Kali, Zef Maka, Zef Mirashi, Marie Buçi, Ndoc Harapi, Rrok Sheldia)....

vijon në faqen 18-19



► Në foto: Disa nga momentet nga jeta e Andrea Skanjeti

PORTRET | ARTISTI

vijon nga faqja 17

...Mysafire në skenën e teatrit "Migjeni" është drama "Votra e huej" e Ndrek Lucës, regjisor Andrea Skanjeti. Më pas, drama "Nora" të dramaturgut Skanjeti, që njëkohësisht është regjisor. Kjo dramë u vlerësua me çmim të parë në konkursin kombëtar që u shpall në vitin 1969. Është një dramë origjinale që i shtohet dramaturgjisë dhe letërsisë shqipe. Rolin kryesor në këtë dramë e luajti me suksese 17 vjeçarja Roza Xhuxha (Anagnosti).

Më vonë "Nora" do të rivihet në skenë. Regjisore është Violeta Sekuj, asistent-regjisor është Tonin Ujka, dekorët u realizuan nga Bep Shiroka dhe Lec Fishta. Në rolin e Norës luajti aktorja e talentuar Justina Alia, duke sjellë një figurë interesante, qëndrestare, plot plastikë që nuk harrohet lehtë.

Vitet kalojnë... Regjisori i palodhur, këmbëngulës e i talentuar Andrea Skanjeti vë në skenë vepra të tjera, si: "Bileta e llotarisë", "Hijet në rrugë", "Udha e drejtë", "Përtej pragut", "Familja e peshkatarit", etj.

Ëndrrën e tij të fëmijërisë për teatrin e zhvilloi dhe e realizoi duke punuar për të më se një gjysmë shekulli si regjisor e shkrimtar, duke i falur një jetë teatrit, një jetë Artisti i Popullit Andrea Skanjeti.

Andrea Skanjeti..., me një bilanc artistik: 190 drama, 86 komedi, 53 farsa, 16 melodrama, 7 opereta, 7 bocete, 4 monologë, 3 skeçe, 1 argëtim poetiko-muzikor, 1 idil e 1 vodevil.

Skeda e katërt: Kujtime, nderim dhe vlerësim për Andrea Skanjetin

AKTORJA VITORE NINO:

"Gjatë punës sime mëse 30 vjeçare, kam patur fatin të shijoj edhe ëmbëlsinë e sukseseve, e kur mendoj për këtë kënaqësi nuk mund të mos kujtoj hapat e para të mija në skenë, përpjekjet dhe djersën e parë. E, atëherë kujtoj me mirënjohje një emër, Andrea Skanjetin regjisor im i parë, mësuesi im i parë në shkollën e madhe të artit teatral. Gjithmonë i përgatitur, gjithmonë i rregullt deri në paraqitjen e jashtme, e këtyre shtoj dhe kulturën e gjithanshme e shijen e hollë prej artisti. Kam punuar dhe me regjisorë të tjerë, nuk do bëj krahasime, veç do të vë në dukje diçka që ka rëndësi, e që mua më ka lënë shumë mbresë: ajo metodë pune, ai stil i përhershëm për ta lënë e nxit aktorin të krijojë vetë, gjë që aktorit i jep zemër, e mobilizon e nuk ia ndrydh aftësitë e tij krijuese."

Aktori Pjetër Gjoka, i la në këtë kujtim:

"Andrea Skanjetit, regjisorit të mirënjohur të skenës, pionierit të saj e dashamirit e kujdestarit më të mirë të punës me aktorin."

AKTORI BEP SHIROKA:

"Andrea është një ndër regjisorët e parë të vendit tonë që punoi në teatër me forma më të sakta profesionale dhe u përpoq të largohej sa më shumë shablloneve të vjetra të trashiguara nga diletantizmi. Andrea për vite me radhë mbas çlirimit udhëhoqi lëvizjen amatore teatrale të rre-



Vitet e fëmijërisë

Kur Skanjeti luante teatër me shokët në ahurin e shtëpisë

Improvizimet e "mendimi regjisorial" për të përgatitur skenën me çarçafë, tullat që shtypeshin për të bërë bojën me të cilën piktori i vogël ("skenografi") pikturonte malet e kodrat në murin e ahurit dhe fushat me barin e njomë, musttaqet me lesh të zi që mezi ngjiteshin me zam, trukazhin e fytyrës me qymyr, shpatat dhe mburojat prej kartoni, etj., etj., - ishin sinjalet të cilat flisnin se Shkodrës po i vinte një regjisor i talentuar që do ta nderonte...

thit të Shkodrës dhe më vonë që regjisor i parë i teatrit profesionist "Migjeni".

Skeda e pestë: Ca relikte... dhe

vitet e fëmijërisë


Mendoj që zgjon interes (mbase pak i përmendur) kontributi i Andreas që dha në lëvizjen teatrore

të teatrit të kukullave, të cilin për misionin e tij fisnik e vlerësonte dhe e përjetonte me botën e madhe të një fëmije.

Zanafilla duhet kërkuar qysh në klasën e parë fillore. Atëherë iu shfaq prirja a pasioni për teatër. Mbase duhen nënvizuar tre elemente: 1. Ndjekja me etje të madhe e në natyrën e tij kurrështare të çdo shfaqjeje, 2. "Regjisor" dhe "aktor" në shumë shfaqje me bashkëmoshatarët e tij në ahurin e shtëpisë, 3. Duke shkruar vetë pjesë teatrore (autor).

Andrea Skanjeti, në një nga faqet e arkivës së tij personale, shkruan: "Vjen një kohë që mbarojnë dëshirat e fillojnë kujtimet!" Duke përfrazuar këtë sentencë të dalë nga një shpirt artisti, kam dëshirë që me kalin e qyqes të fluturoj nëpër vite e të trokas në dyert e fëmijërisë e të kujtimeve të Andreas, pikërisht atëherë, kur ishte në fillore, e si një ylber shumëngjyrësh iu shfaq pasioni për teatrin, kur për të skena do të bëhej një tempull i shenjtë. Duke përmendur reliktet e fëmijërisë së tij, shënojmë se shfaqjet i ndiqte me ëndje e etje, gjë që do t'i falnin tharmin e fantazisë për të vënë më pas shfaqje me bashkëmoshatarët. (Improvizimet e "mendimi regjisorial" për të përgatitur skenën me çarçafë, tullat që shtypeshin për të bërë bojën me të cilën piktori i vogël ("skenografi") pikturonte





malet e kodrat në murin e ahurit dhe fushat me barin e njomë, mustaqet me lesh të zi që mezi ngjiteshin me zam, trukazhin e fytyrës me qymyr, shpatat dhe mburojat prej kartoni, etj., etj., - ishin sinjalet të cilat flisnin se Shkodrës po i vinte një regjisor i talentuar që do ta nderonte. Dhe ashtu ndodhi vërtet...).

Po përmendim edhe disa relikte të tjera: Andrea i vogël po përfundonte filloren. Moshë e vocërrakut fliste për pasionin e madh që kishte për librat, të cilat i kishte blerë duke i lexuar pothuajse të gjitha librat e botuara nga tri shtypshkronjat e qytetit të Shkodrës: "Nikaj", "Franceskanëve", "Zoja e Papërlyeme", pa harruar edhe ndonjë libër të botuar jashtë shteti. Kështu nga bota e madhe e librave (si nga bota e yjeve) Andrea kërkonte një galaktikë të re: Dramën. Me kurajo e guxim fëmijëror vendos dhe shkruan një pjesë teatrore të titulluar "Kusarët", me katër akte. I ndrojtur ia jep mësuesit të tij, Luigj Kromiqit, për të cilin flet me aq dashuri e sinqeritet, plot dritë e simpati. Mbase do të kisha veçuar një moment, atë të taktit të mësuesit, në një paragraf të zgjedhur si ky: "Sot do të merremi me një hartim të bukur, që më çuditi e më gëzoi. Një nxënës i imi ka shkruar një pjesë teatri që trajton një subjekt shoqëror... të titulluar "Kusarët" e nxënësit tonë. Por... pak kujdes këtu, nuk është tragjedi, por një dramë në prozë me katër akte, të cilën, ne, me leje të Drejtorisë së Shkollës, do ta vëmë në skenë, pra, do ta shfaqim për nxënësit e shkollës dhe familjet e tyre në sallonin e teatrit të shkollës".

Drama "Kusarët" e nxënësit Andrea Skanjeti, shtjellon një ngjarje shoqërore-familjare, ku dënohet grabitja e vjedhja. Vendi dhe koha e ngjarjes janë të papërcaktuara. Shtrirja e dramës, dialogu, karakteret, vizatimi i skenave, etj., etj., kanë stil, ngjyrim e fantazi fëmijërore, të cilat përligjin moshën e vogël të autorit.

Për këtë dramë jam i një mendje me mendimin e aktorit Sokol Progrid, kur thotë: "Kjo dramë, ndonëse e krijuar në një moshë të njomë, mbetet një ngjarje e shënuar në jetën e Andreas, jo shumë për vlerat e saj artistike, sepse vetë moshë e niveli ia kufizojnë një mundësi të tillë, por

edhe për faktin se ajo u vlerësua dhe u vu në skenë me klasën e tij, nën drejtimin e mësuesit të tyre (Luigj Kromiqi, - shënimi im Xh. B.). Veç kësaj interesant është fakti se në personazhet e saj ishte një femër, gjë që ishte në kundërshtim me dramën e atyre viteve".

Kësaj drame modeste, që për autorin la gjurmë të thella në shpirtin e tij, i dhanë jetë në skenë, me interpretimet e tyre edhe nxënësit: Matish Prendushi (dilte për herë të parë në skenë), Zef Qerraxhia, Lin Koka, Zef Çoba (në rolin e vajzës), Gjovalin Çurçia, Kel Abati, Andrea Skanjeti.

SKEDA E GJASHTË: I PASIONUAR EDHE PAS TEATRIT TË KUKULLAVE

Nga fundi i vitit 1951 u krijua Teatri i Kukullave në Shkodër. Kjo detyrë fisnike u besua njeriut-fisnik Andrea Skanjetit, i cili është dhe regjisor i parë edhe në këtë

teatër fëmijësh (i kukullave). Sipas Andreas: "Për fëmijët, një ndër artet më të përzemërta, është ai i teatrit, veçanërisht i kukullave, i cili është me shumë efekt, sepse i përshtatet moshës së tyre".

Detyrën për krijimin e teatrit të kukullave regjisor Skanjeti e pranoi me kënaqësi dhe njëheri me guxim të madh. Këtë guxim ia dha edhe e shoqja, Njomi, e cila u angazhua dhe e ndihmoi në bërjen e kukullave. Delikatësa dhe arti në qëndisje, mjeshtria në rrobaqepësi, shpirti human, etj., - ishin disa nga cilësitë e saj që i shfaqti orëve të ditës e të natës, aty, në kuzhinën që ishte kthyer në atelje, ku merrnin formë fytyrat njerëzore e të kafshëve në kallëpe plastike që më vonë do të visheshin me butafori, si dhe me pëlhura dhe lëkura të ndryshme. Pra, kuzhina-atelje u kthye në një skenë njerëzore e përrallore, ku lëviznin personazhe:

nëna, gjyshi, Liljana e vogël, Kreshniku me shpatë, keci, dhelpra, ujku, lepuri, ariu, zogu, milingona, etj., etj.; një galeri e tërë që rrinin në pritje të merrnin "frymë" e të "flisnin" ashtu të veshura në duart e aktorëve.

Teatri i Kukullave filloi të bëjë emër të mirë në qytet. Deri në vitin 1958 Andrea si regjisor vë në 11 pjesë. (Shumë prej tyre janë të shkruara nga vetë Andrea Skanjeti). Kujtojmë: "Qypi e bilbili", "Liljana e vogël", "Farkëtar i lumturisë", "Tre kecat", "Hirushja", "Mësimi i gjyshit", etj.

Në vitin 1961 vë në skenë 4 pjesë të përkthyer nga autorë të huaj, si: "Druvari", "Gjoni i fortë", "Familja e gëzuar", "Lumturia".

Ndër shfaqjet e fundit do të përmendim: "Çeta e vogël e Skënderbeut", "Gjumashët" (dramë me tre akte nga Kolë Jakova), dhe këto



shënojnë 23 premiera me një veprimtari rreth 15 vjet që drejtoi me dinjitet regjisorin dhe dramaturgun Andrea Skanjeti. Në këtë hapësirë kohore deputuan rreth 60 aktorë, si: Julka Kakarriqi, Kolë Jubani, Loro Banda, Kolec Pepa, Aneta Nikaj, Naim Tyli, Ramiz Rama, Bora Meta, Rrok Dajçi, Fehmi Doraci, Tinka Kurti, Rrok Nënshati..., etj. Nuk do të harrohen edhe kompozimet muzikore të Artistit të Popullit Prenkë Jakova e dekoret e punuara plot shije e fantazi nga Lec Fishta.

Pra, për 15 vjet rresht nën drejtimin e regjisorit e dramaturgut Andrea Skanjeti, lëvizën nëpër 23 premiera plot e plot personazhe, që me interpretimet e tyre fituan duartrokitjet e spektatorëve të vegjël.

Dhe si një yll që kurrë nuk bëhet meteor, rri përjetësisht dhe kujtimi i regjisorit dhe dramaturgut Andrea Skanjeti, i cili shpërndan një dritë të tillë: "Jam shumë i kënaqur, që

gjatë ushtrimit të profesionit tim si regjisor, krijova teatrin e kukullave dhe dhashë për të pa kursim të gjitha mundësitë e mia mendore e fizike. Jam i lumtur se puna ime modeste ka shërbyer sadopak në edukimin e masës së re që po rritej e lumtur e plot shëndet... Njëzet e tre premierat e realizuara më krijuan mundësi që të qëndroja për shumë kohë pranë buzëqeshjes së sinqertë të fëmijëve, në dëfrimin e gëzimitin e tyre, në gazin e harenë që mbushte sallën para shfaqjes dhe kënaqësinë që provonin ato pas saj.

Edhe sot më bëhet sikur e dëgjoj atë ushtrimë hareje si zgjoj bletësh, edhe sot do të përrihesha me një punë të tillë plot kënaqësi."

SHKODËR, GUSHT 2017

Literatura e shfrytëzuar:

-Andrea Skanjeti: 100 vjet teatër në Shkodër, Shkodër 2002.

- Dosja "A. Skanjeti", arkivë personale.

-Marian Skanjeti: "Andrea, vëllai im..." (kujtime).

-Josif Papagjoni: Teatri i Shkodrës, Shkodër, 2009.

-Flori Slatina: 55 x 2 Portrete Artistësh, Gazeta "55", Tiranë, 1999.

-Sokol Progrid: Jeta dhe veprimtaria artistike e Andrea Skanjetit, (punë diplome), Shkodër, 1983.

-Dorina Arapi: shkrimi: Shkodra si strehë e të ikurve (Roli i qytetit në dinamikën e lëvizjes së individëve në mesin e shekullit XIX), Gazeta Shqiptare, Suplementi Milosao, 20.08.2017, f. 12.

SHENIME:

Sipas pohimeve të filatelistit Besnik Fishta: "Andrea Skanjeti ka qenë një koleksionist i talentuar pullash postare (filatelist) me pjesëmarrje aktive në jetën e Klubit Filatelik të Shkodrës, që është Klubi i parë në Shqipëri që nga krijimi i tij, më 1947. Në vitin 1972 Andrea përfundoi katalogun e pullave postare shqiptare në dy gjuhë Shqip-Frëngjisht duke pasqyruar periudhën 1913 - 1972, në të njëjtën metodikë si ato të shteteve përendimore. Ky është botimi i parë i këtij lloji në Shqipëri, bile deri më sot nuk është arritur akoma nga tjetërkush. Duke shfletuar në Arkivën e Shtetit në Tiranë, unë e kam parë vizualisht këtë katalog para disa vitesh."

PORTRET | AKTORI

NGA MARK BRUNGA

Në lagjen e vjetër "Varosh" të qytetit të Durrësit, e cila njihej vitet e pasçlirimit në ndarjet e reja administrative si lagja nr 11, kalonte çdo ditë një personazh interesant, banor i kësaj lagjeje. Ishte Gaqo Spiru. Përshëndeste të njohur, por edhe u kthente me mirësjellje përshëndetjet të panjohurve që e salutnin. Dhe kjo kategori ishte e shumtë. Pasi shumë prej tyre nuk e dinin se ku punonte, por e vlerësonin si aktorin që ka luajtur në filmin "Toka e Jonë" me aktoren e madhe të skenës shqiptare Marie Logorecin, ose me Loken e famëshme. Ky rrol i kësaj aktoreje ishte realisht një kryerol i sajë, suksesi i të cilës vazhdoi gjatë gjithë jetës së Marie Logorecit. Kjo pasi drama që luajti ajo, "Toka jonë" qe edhe drama që ngrii lart një plejadë aktorësh të mëdhnj shqiptarë. Një prej tyre ishte edhe roli i Metit, që luajti Gaqo Spiro.

Në atë periudhë vepra e Kolë Jakovës "Toka jonë" (1954) vlerësohej shumë. Ajo qe kthyer, sipas një studimi të Josif Papagjonit, në një vepër antologjike në traditën e dramaturgjisë shqipe të të ashtuquajturit Realizëm Socialist. Kjo dramë dhe vetë emri i Kolë Jakovës ka shijuar sa parajsën aq dhe ferrin, sa lavdërimet pa fund aq dhe mallkimet dhe talljet pa fund, thekson Papagjoni. Në të shfaqej rilindja shpirtërore e njeriut dikur të ndëshkuar me pa të drejtë dhe të përbuzur, që përfaqësohet nëpërmjet fatit të Lokes, që përbën trugun ku lidhen gjithë nyjat e tjera të subjektit dramatik. Sado që veprimi dhe konflikti ngërthehen fort pas rrethanës social-politike gjatë zbatimit të reformës agrare në vitin 1946, manipulimit të faktit historik si dhe antagonizmit të pushtetit të ri komunist në shpronësimin e dhunshëm të kulakëve, e vërteta e dramës dhe thelbi i saj, sipas Papagjonit, mbetet gjithëpoaq edhe çlirimi i njeriut nga mashtrimi, e keqja dhe rivendosja e të drejtës së nëpërkëmbur. Drama të ngazëllen me unitetin dhe kohezionin e fortë kompozicional të ngjarjeve, konfliktit, me rrjedhshmërinë logjike, dendurinë e informacionit në njësinë dialogjike të saj, me situatat e skajshme dramatike, aksionin e shpejtë, tensionin. Këtë nivel loje aktoreske në këtë dramë e përballoi edhe Gaqo, përkrah figurave brilante të skenës sonë si Marie Logoreci, Loro Kovaçi, Marjo Ashiku, Vangjel Heba, Roza Anagnosti etj.

Gaqo ne hapat e para të artit skenik Miqtë e Gaqos tregojnë për të se ai krijoi personalitetin e tij në saj të karakterit të fortë, ndërgjegjes së pastër dhe përkushtimit. Për shkak të pasionit të veçantë bëhet ndër të parët aktor amator në teatrin e Durrësit, që ndodhej në atë periudhë tek kinema "14 nëntori". Ndërtesë që ishte njëherësh edhe kinoteatër. Vijon studimet e larta në Fakultetin Histori-Gjeografi. Gaqo Spiru i përket plejadës së parë të aktorëve që themeluan teatrin profesionist në Durrës. Me 11 janar 1953 vihet në skenë komedia e parë "Vajza nga fshati", ndërkohë që me themelimin e teatrit, më 8 shkurt 1964 vendoset në anën e krijuesve të trupës profesioniste. Teatri fillimisht e më pas filmi do të krijojnë personalitetin e fortë të këtij aktori, emri i të cilit do të qëndrojë në listën e më të mirëve aktorë shqiptarë. Për shkak të pjekurisë, të ndihmesës së drejtpërdrejtë në çlirimin e vendit dhe meritave profesionale, Gaqo Spiru emërohet në vitin 1968 drejtor i teatrit "Aleksandër Moisiu". Qëndrimi i tij në këtë post të vështirë i jep shtytje të madhe ecjes së estradës dhe teatrit. Falë mbështetjes dhe inkurajimit të tij u bë e mundur kapja



► Në foto: Disa nga momentet nga jeta artistike e Gaqo Spiru



JETA DHE LIDHJA ME DURRËSIN, QYTETIN E TIJ TË LINDJES

Daljen në publik si aktor e nisi që në moshë fare të vogël. Fillimisht në grupet amatore të krijuara pas Çlirimit të vendit. Aty u shfaq prirja e tij për t'u bërë artist profesionist. Jeta artistike e Gaqo Spirus qëndron mes aktorit të teatrit dhe atij të filmit. Durrësi është qyteti që i dha jetë dhe lavdi emrit të tij. Sa herë që vjen koha për të shikuar pas dhe për të matur rugën e përshkuar të artit në Durrës që nga koha e hapave të parë të ngritjes dhe konsolidimit të trupës profesioniste, mendja dhe sytë shkojnë tek emrat më të dashur për të gjithë: Nikolin e Meropi Xhoja, Spiro e Vera Urumi, Todi Thanasi, Teodor Rupi, Vangjel Heba, Gjergj Vlasi, Lutfi Hoxha... Janë ata që jo vetëm e ngritën trupën profesioniste, por edhe bënë mrekulli në skenën e estradës dhe të teatrit. Miqtë më të afërt të Gaqos, sipas gazetarit Xhevo Gradica, kanë qenë Nikolin Xhoja, Vangjel Heba, Anastas Bojaxhiu (profesori i parë në Durrës), Marta Burda, Lazer Murati, Kadri Pirro, Todi Thanasi, Milto Profi për të vazhuar me estradën dhe me emrat e Ramazan Njalës, Spiro Stratit, Aleksandër Pepës, Enver Likmetës... Dhjetra role të lozura prej tij në teatër. Në shumë prej tyre në role kryesore. Arkiva e teatrit "Aleksandër Moisiu" ka dhjetra foto në të cilat fiksohet artisti në skenë. Dalja e parë e tij si aktor i nivelit profesionist i përket vitit 1953 "Vajza nga fshati" me rolin e Palit. Asokohe Spiru ishte 25 vjeç. Kishte kaluar provë pas prove me trupën amatore. Njëra pas tjetres vinë 24 role në teatër. Role nga më të larmishmet të cilat u luajtën me mjeshtëri të rrallë. Teatri arriti të jepte 5 e 6 premira në vit, ndërsa trupa e estradës po bënte revolucion në anën tjetër duke e vendosur qytetin e Durrësit në epiqendër të aktiviteteve kulturore kombëtare. Temat ishin të larmishme. Shumë prej tyre kishin në qendër luftën për çlirim. Të tjerat edukimin qytetar, depërtimin e moralit të ri, luftën kundër paragjykimëve, emancipimi femrës, roli rinisë, jeta në fshat, ngritja e kantierëve...Për shkak të kulturës së lartë në interpretim Gaqo Spiru u zgjodh për t'u bërë pjesë e trupave në realizimin e disa filmave. Kështu emri tij spikat në rolet kryesore në disa prej tyre si tek "Toka jonë" me figurën e Metit; "Detyra e posaçme" me rolin e nënkolonelit; Petro motoristi në "Horizonte të hapura"; gazetari "Përse bie kjo daille"; organizatori i grupit në burg "Njësitë guerile"; "Nusja dhe shtetrrëthimi"... Pikërisht në këtë periudhë që nis në vitet 1963 dhe shtrihet për dy dekada do të ketë fatin të lozë përkrah ikonave të kinematografisë shqiptare,

Gaqo Spiru

Aktori durrsak që u dha jetë dhjetra roleve krah yjeve të teatrit e filmit

Ai luajti role dinjitoze përkrah Marie Logorecit dhe gjigandëve të tjerë të skenës shqiptare.. Historia e një artisti dhe kujtimet e miqve të tij për jeetën karrierën dhe karakterine tij njerëzor...



e rekordit, përgatitja brenda 12-13 ditëve e shfaqjes së premierës. Pikërisht në këtë periudhë, e cila përkon me prurjet e reja të artistëve që vinin nga Instituti i Lartë i Arteve, emri teatrit dhe estradës së Durrësit sa vjen dhe bëhet më i dëgjuar. Rreth kësaj trupe qëndron emra të niveleve kombëtare, ndërkohë që turnetë në trevat shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Mal i Zi në vitin 1973 ia zgjerojnë gjeografikisht famën. Po në jetën e tij një vend të veçantë zinte edhe familja. Edhe pse jeta e aktorit Gaqo Spiru ka qenë e ngarkuar me punë, ai ka mundur të gjejë kohë edhe për familjen. Djali Ivo, i cili trashëgon emrin e të atit të aktorit dhe vajzat Keti e Ilirjana kanë shijuar gjatë kënaqësinë që afron prindi teksa merr duartrokite të pareshtuara në skenë. Sapo i krijohej mundësia më e vogël mbledhje me fëmijët dhe aty sajonte lojra e biseda të cilat jo vetëm argëtonin, por edhe edukonin fëmijët. Spiru nuk e pëlqeu kurrë pijen, ndaj nuk rrinte gjatë në lokale. Kjo i dha mundësi të shfrytëzojë kohën për t'u përgatitur, për të shkruar pjesë të ndryshme ngase veç aktorit në teatër e në kinema, tjetër prirje e tij qe edhe regjisura.





përkrah aktorëve më të mëdhenj të të gjitha kohrave si: Marie Logoreci, Roza Anagnosti, Sandër Porsi, Ndrek Luca, Pjetër Gjoka, Ilia Shyti, Lazer Filipi, Pandi Raidhi, Dhimitër Orgocka, Robert Ndrenika, Nikolin Xhoja, Sulejman Pitarka, Vangjel Heba...Aktori nga Durrësi bëhet figurë shumë e adhuruar. Regjisorët dhe aktorët panë tek Spiru personazhin e shkrirë plotësisht dhe qetë e pastër në rol. Ky lloj mishërimi bëri që atij t'i besohen role shumë të veçanta si në rastin e Metit tek "Toka jonë", nënkolonelit tek "Detyra e posaçme" etj. Kolegët ruajnë mbresa të jashtëzakonshme për të në ditët e xhirimeve. Gaço kishte aftësi të sfidonte çdo gjë: rolin e vështirë, motin e keq, pagjumësinë, lodhjen... Nuk ankohej asnjëherë. Rolin e merrte shtruar dhe me vullnet duke depërtuar shumë shpejt brenda karakterit të personazhit. Fakti se Spiru e nisi karrierën artistike në teatër, i dha mundësi të

na pritën shumë mirë. Gaço qe aktor i ngrohtë, i aftë, dashamirës. Ishim katër vajza që patën kryer Artet: unë, Filika Domo, Donika Barçi dhe Luixhina Leka. Ishim të reja dhe kishim nevojë për mbështetje, për kurajo. Tek Gaço gjetëm aktorin e pjekur, mikun dhe shokun e mirë që na përkrahu në rrugën e skenës". Gaço, thekson Stari, bën pjesë tek trupa e aktorëve që e ka justifikuar shumë mirë rolet. Sot, duke kujtuar pjesët e lozura nga miku ynë Gaço në teatër e në film, çmalem, ashtu si dhe me Vangjelin, Nikolinin e të tjerë. Gaço qe për shumë kohë drejtor teatri, detyrë shumë e vështirë. Në teatër është sakrificë e madhe të drejtosh. Aktorët kanë pretendime pa fund. Me qetësi dhe urtësi i zgjidhte të gjitha. Një grup aktorësh kishim edhe hyrja-dalje familjare. Kështu që së bashku, shkonim orë e pa orë në shtëpinë e Gaços. Këtë miqësi e shfrytëzuam shumë

shef i Seksionit të Artit e Kultures ishte z. Gaço Spiru. Ai vinte nga fusha e artit dhe kultures dhe i vleresonte talentet dhe te rinjte, i perkrahte dhe i nixiste piktorët në zhvillimin e arteve figurative. Në Galerinë e Arteve Durrës filloi të funksionojë rregullisht stimuli moral dhe material, vlerësimi dhe blerja e vepra të artit, gjë e cila çoi në zhvillimin e arteve figurative në Durrës". Piktori Risilia thotë se është i vecante kontributi i Gaços, në perkrahjen e artisteve të rinj, atyre amatore dhe profesionistëve: " Është për t'u përmendur se nuk bente dallime origjine apo prejardhje, ishte novator dhe kurajoz", thekson ai. Artisti Gaço Spiru me punën e tij të palodhur si shef i kultures e artit në Durrës vendosi një gur të cmuar në themelet e qytetit Durrës, duke lënë mbresa e kujtime të çmuara me argumentimin bindës për

Gaço dallon nga të tjerët me një diksion brilant, lojë e vertetë dhe bindëse. Gaço Spiru e ndante shume bukur lojen në teatër me atë në film.

Pengu im i madhe është se në teatrin "Aleksander Moisiu" nuk ka fonotekë e videotekë të repertorit të tij shumë të pasur. Por për fat të mirë një elite aktoresh të teatrit të Durrësit kanë qenë të përzgjedhur në kinematografinë shqiptare. Një nga këta ishte Gaço Spiru si për diksionin edhe për portretin e tij ekspresiv.

ROLET NË TEATËR 24 :

"VAJZA NGA FSHATI" 1953 Pali
 "DASMA E MADHE" 1954 Rexhep Ceka
 "SHKARKUESI I PARE" 1957 (OPERETE)
 "DREQNIT E KENETES" 1956
 "DREDHITE E SKAPENIT" 1957 Argonti
 "LJUBOV JAROVAJA" 1957 Kolonel Melini
 "MBRAPA MUREVE" 1957

Sotir Shytaj
 "TE RINJTE" 1958 Bujari (përgjegjes i njesitit të fshatit)
 "KERKUESIT E LUMTURISE" 1958 Damian Mikolov
 "CESHTJA IVANOV" 1959

Mekov
 "UDHEKRYQJE E BARRIKADA" 1959 Civili
 "BIRI I HUMBUR" 1960 Lambit Medejari "NOTA "O" NE SJELLJE" 1960 Stefan Vardia (kryesor)

"SEMUNDJE E RREZIKSHME" 1960 Aliu (kryepuntor)
 "E DELEGUEMJA" 1961 Sula (përgjegjes blegtorie)
 "VOTRA E HUAJ" 1961 Lini
 "ATA U RRITE NË LUFTE" 1962 Czhao Lao Czhun (drame kineze)

"NDALESA E FUNDIT" 1962 Koh (ushitari)
 "SHUFRAT E HEKURTA" 1962 Gazmend Pojani
 "INVADIMI" 1963 Fajunjin Nikollai Sergejevic

"JASHTE BIE SHI" 1964 Profesori

"HIJET E NATES" 1964 Sotiri

"RRUGE TE TERTHORTA" 1965 Aliu (komandant brigade)
 "PULBARDHA" 1965 Shamrajev

SI AKTOR NË FILMA 6 ROLE:

"DETYRA E POSACME" 1963 Nen-kolonel sig.

"TOKA JONE" 1964 Meti
 "HORIZONTE TE HAPURA" 1968 Motorrist (sek.parte) "PERSE BIE KJO DAULLE" 1969 Gazetari

"NJSITI GUERIL" 1969 Organizator i grupit në burg
 "NUSJA E SHTETRRETHIMI" 1976-7

Aktori i shquar durrsak Gaço Spiru ka lindur në Durrës më 18 maj 1927 dhe është ndarë nga jeta më 22 tetor 2002.



shumta për t'u përshtatur pa shumë vështirësi në rolin e aktorit të filmit. Mjeshtëria për të aktruar në skenë, shkruhet në biografinë e aktorit, që një shans e fat më shumë për të. Kjo e bëri emrin e tij simpatik dhe të adhuruar tek regjisorët dhe aktorët. Loja përkrah Marie Logoreci e cila tek "Toka jonë" qe Lokja, apo në krah të Ndrek Lucës, Sandër Posit tek "Detyrë e posaçme" ishte shkollë më vete për aktorin e Durrësit. Gjithnjë energjik, i saktë, i palidhur dhe emocionues, rol pas roli.

AISHE STARI KUJTON:

Aishe Stari Mjeshtre e madhe, në një intervistë ka thënë se Gaço Spiru ka qenë shumë aktiv si aktor dhe qytetar. "E njoha sapo përfundova studimet e larta në art. Trupa e Durrësit

për të diskutuar për skenën, estradën, teatrin, tematikat, rolet. Shkonim shumë mirë dhe kjo harmoni i dedikohet edhe Gaços që diti të na orientojë me qartësinë e mendimeve të tij.

VLERËSIMI NGA PIKTORI KOÇI RISILIA

Në kujtimet e veta piktori durrsak Koçi Risilia përshkruan me emocione atë pjesë të jetës së tij artistike ku ka ndjerë ndihmen e drejt oëdrejtë të Gaço Spirus, në detyrën e drejtuesit kryesor të artit dhe kulturës në Durrës. Ai tregon: "Jam ndjere shume i lumtur dhe i vlerësuar kur, ndonse piktor i ri, mua me dhane një studio pikturë ku mund të ushtroja profesionin tim si piktor. Dhe kjo gje ndodhi në vitin 1973, atehere kur

probleme të ndryshme, me drejtësinë dhe bujarinë, me tolerancën dhe novatorizmin e tij në art e kulture.

Lutfi Hoxha: Gaço Spiro aktor me zë dramatik dhe diksion të rrallë

Aktori Lutfi Hoxha thekson se tek Gaço Spiru si aktor veçon zerin e tij shumë kumbues, zë dramatik, që shoqërohej me një diksion të rrallë, diksion i vecante, dhuratë nga natyra. Tek drama "Mbrapa mureve" e Kolë Jakoves, dramë me shume interes, ai spikat shume si loje aktoriale, me zë të kumbueshëm, bariton i lakmuar, me diksion të mrekullueshem dramatik, dhe me profil tërheqës që e bënte spektatorin për vete.

Tek filmi "Detyra e posaçme", ku kam luajtur edhe unë një rrol, kujton Lutfi,

KUJTIMET | KINEMA



NGA NAUM MARA

Në Majestiku...

Kinemaja, ku thureshin ëndrra me Çaplin e Greta Garbo

Kinemaja ishte më pak se 100 metra larg nga Liceu Francez dhe studentët e tij shkonin për të parë filma edhe në orarin e mësimëve. "Majestiku" ishte qendra e jetës kulturore rinore.

Nuk e kam vuar mendjen ndonjëherë, se si ishte sheshi i vogël para kinemasë, para se të ndërtohej "Majestiku". Besoj se duhet të ketë pasur banesa të vogla një dhe dykatëshe. I gjithë kompleksi, duke përfshirë "Bar Republikën" ishte ndërtuar më mirë, se gjithë ndërtimet përreth. Prej ndërtimit ka "sunduar" formulimin arkitekturor të atij sheshi. Kishte qënë meritë e projektuesve, e ndërtuesve apo një kombinim i mirë i të dy palëve, por e vërteta është, që ndërtimi edhe pse me një hapësirë të madhe brenda, i rezistoi tërmeteve të fuqishme të viteve 1930 dhe 1960. Në krah të tij, Kisha e Shën Sotirit (e vllahëve), ndërtesë e të njëjtës madhësie, u rrëzua në tërmetin e vitit 1930 dhe më vonë u "fshi" përfundimisht nga pjesa qendrore e qytetit.

"Majestiku" nuk ishte e para kinema në Korçë. Para saj, si sallë shfaqesh filmi kishte funksionuar salla në "kazinjoja" në të hyrë të pazarit dhe më vonë ishte ndërtuar kinema "Llaksi". Por "Majestiku" ishte kinemaja më e madhe dhe më luksoze në Shqipëri dhe një nga më të mirat e Ballkanit, kur u ndërtua. (Vlerësimin e fundit e kam marrë nga "Gazeta e Korçës" e vitit të përfundimit, pasi do më duhej të gërmoja shumë në historinë e ndërtimit të kinemave në Greqi, Rumani, Jugosllavi dhe Turqi, për të pasur një ide më të saktë se në ç'vend nderi qëndron kinemaja e Korçës.)

"Majestiku" ishte "vendi i takimit" të rinisë korçare me Europën dhe Amerikën. Kishte më shumë vende se "Llaksi" dhe njëkohësisht ofronte mundësi edhe për shfaqje të thjeshta teatri, me skenën dhe aksesoret e saj. Për më tepër ishin llozhat, ku grupe të rinjsh mund të

shijonin në grup shfaqjen e filmit, ose edhe "të lëshonin" batutat, si bëhej në çdo sallë në botën e zhvilluar. Sigurisht, që nuk kishte të njëjtën atmosferë, si ajo e filmit të famshëm "Kinema Paradiso" i Tornatores, pasi Korça ishte ku e ku më e përparuar se qyteza sililane, në të cilën zhvillohen ngjarjet e atij filmi.

Kinemaja ishte më pak se 100 metra larg nga Liceu Francez dhe studentët e tij (çuditërisht ata të Liceut nuk janë thirrur kurrë në Korçë nxënës), shkonin për të parë filma edhe në orarin e mësimëve. "Majestiku" ishte qendra e jetës kulturore rinore. Endrrat me Greta

Garbon, Carli Caplin, Al Xholson (një qytetar i njohur i Korçës mbajti nofkën "Allxhollson" gjithë jetën e tij) thureshin pikërisht në këtë qendër kulturore.

Qyteti ishte në lulëzim të plotë pas Luftës së Parë Botërore dhe kishte marrë një "sharm" francez edhe si pasojë e ndenies së francezëve për gati 5 vjet, që prej vitit 1915 e deri në vitin 1919. Kjo kishte bërë, që edhe shumë të huaj të vinin e të punonin në Korçë. Qyteti sa vinte e popullohej me të ardhur nga fshatrat e qarkut, Përmetit, por edhe Gjirokastrës. Të ardhurit rishmë ishin të etur të

mësonin ato, që ofronin qytetet europiane të kohës, duke filluar me veglat muzikore dhe duke përfunduar në "dansi". Mësues të dansit dhe muzikës patën ardhur nga Greqia dhe Italia. Mes tyre, një i lidhur ngushtë me kinematë dhe sidomos me "Majestikun" ishte Grigoris Metaksa. Muzikanti grek, ishte për vite të tëra "shpirti" i filmave pa zë, të cilat në gjithë botën shoqëroheshin me muzikë "live" në piano gjatë shfaqjes. Një pjesë e mirë e pjesëve luheshin me partiturë, por nuk mungonte edhe improvizimi i pianistit. Deri vonë,

ka erdhur jehona e korit të të rinjve korçarë, që nën tingujt e njohur të pianos të filmave, që i shihnin disa herë rradhazi, këndonin "Ku e ke lojtur Metaksa/ Në bulevard, në sinema". Muzikanti grek, njohës i disa instrumentave, jepte edhe mësimë private, por lidhja e tij me kinemanë mbeti legjendare edhe dhjetvjeçarë të tërë pas largimit nga jeta. E tillë ishte pesha e "Majestikut".

Kinemaja është e lidhur me shumë emra të njohur të qytetit, duke nisur me pronarët e saj dhe familjet e tyre dhe duke përfunduar me "operatorët" e pasluftës apo ngjarjet historike brenda saj, duke nisur me gjyqet famëkeqe, konferencat, por edhe shfaqje të sukseshme teatrale. Nuk kanë munguar shfaqjet dhe ngjarjet politike edhe në kohët më të reja. Por do veçoja edhe një emër tjetër, i lidhur me kinemanë, që ka mbetur disi në heshtje gjatë dy dhjetvjeçarëve të fundit. Ai i piktorit të madh korçar Guri Madhi, ose si njihej në rininë e tij, Guri Vëthka.

Guri ka qënë talenti më i madh në pikturë, që ka nxjerrë Korça, por për shkak të shtrirjes së veprimtarisë së tij artistike vetëm gjatë kohës së Diktaturës, nuk mundi të arrinte shkëlqimin e Vangjush Mios.

Që kur ishte adoleshent, punonte reklamat e filmave, që shfaqeshin në "Majestiku", bazuar mbi "koperinat" e krijuara në Hollivud apo Francë. Fasada e "Majestikut" mbajti për vite të tëra, "vulën" e furçave të përdorura me mjeshteri nga Guri, deri në kohën kur piktori shkoi për studime të larta në Bashkimin Sovjetik.

Ishin breza të tëra korçarësh, që u lindën me "Majestikun" dhe u bënë artistat nën ndikimin e tij. Ndohta një ditë do i rikthehet lavdia dhe ndikimi.

Edhe shkëlqimi i emrit të madh, që mban.

FJALËKRYQESH

NGA **KADRI VOKOPOLA**



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI **38** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

- Qe djalë i Eolit.
-Fillojnë afrimin.
-Është numri 1.
- Dashuron Adinan.
-Si qendër
- Janë diletantët.
-Janë ujëvarat.
- Moduli që u ul në Hënë.
-Janë mjetet me para
- Bien edhe me rrebes të tilla.
-Bëhen nën me trehapësh në tabelë.
- Inicialet e Asimov.
-Dhia që ushqeu Zeusin.
- Të parat në ceremoni.
-Është si unazë.
-Thomas Mann.
- Fitzgerald që qe aktore
8. Mund të jetë kozmike
-Inicialet e Paganini-t.
-Një ndalim në pranga.
- Në mes të një kanali.
-Sergio që qe kantaurot italian.
- Inicialet e Altman.
-Me të bëjnë trarë.
- Ente Tregtare Kavajë.
-Hyrë në zemër
-Vlen për të çkoduar një mesazh.
- Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
-Immanuel filozof.
-Gjysmë atomik.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

K	A	R	A	T	E	K	E	V	I	N	M	A	S	H			
O	P	E	R	A	H	A	D	R	M	A	R	I	A				
M	E	R	E	P	O	L	E	P	O	S	I	T	I	O	N		
E	L	A	F	E	N	O	M	E	N	A	L	E	N	I			
N	I	D	E	M	O	R	A	L	I	Z	I	M	I				
T	P	E	R	B	R	I	E	K	M	A	N	E	T				
I	K	E	R	E	I	F	U	M	E	T	A	N	I				
A	N	D	E	R	S	E	N	P	E	T	I	T	R				
R	A	D	I	O	T	R	O	R	T	E	K	E	A				
S	I	M	B	O	L	I	Z	M	I	R	E	M	N				
A	M	E	N	U	M	A	T	A	R	A	E						
S	T	I	N	G	F	E	R	R	A	R	I	S	T	E	T		

- Fare pa fe.
12. Vrapojnë në pistë.
-Patricia këngëtare.
-Zola që shkroi Nana.
- VERTIKAL
- Nin që qe shkrimtare.
-Antonio që qe skulptor
 - Stema pa ekstreme.
-Është bisha ridens
-Të parat në olimpiadë.
 - Rodrigues që këndonte fado.
-Një pjesë e elementeve.
4. Taulanti kërkon një...
 - Mund të jenë transporti.
5. Është erë kafeje
-Kështu thirret një amerikan.
 - Ndërmarrje Industriale Rajonale
-Një pemë.
 - Teke tende.
-Edward, regjisori i Shalako.
 - Unë... italian
-Film i James Foley.
 - Një shtet aziatik
9. Shkroi Kim.
-Fillojnë nazet.
 - Është porosia e fundit
 - Janë besimtarë
12. Një karavelle e Kolmbit
13. Reparte Civile Italiane.
-Janë dollapët.
 - Me... Benz në Mercedes.
-Një cigan.
 - Teke klase.
-Nasi shkrimtar
 - Torta pa zanore.
-Lista pa çifte.
 - Pacino aktor
17. Paul që qe piktor
-Një rrenjë matematike

FJALËKRYQI SPORTIV

	1	2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31	32	33	34	35
36	37	38	39	40	41	42	43	44
45	46	47	48	49	50	51	52	53

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

R	F	S	H	I	M	A	B	E	N					
A	H	S	I	M	A	R	T	I	N	A				
T	I	R	A	N	A	I	Z	T						
K	A	M	A	T	A	T	A	S	T	R	O			
A	T	M	I	L	A	N	I	N	T	E	R	R	I	G
S	T	O	N	E	R	I	A	N	T	O	N	I	O	
A	T	A	F	E	T	A	R							
E	R	A	A	A	A	A	A							
L	I	R	I	D	O	N	L	A	T	I	F	I		
A	T	O	R	G	E	S	S	H	E	H	I			

HORIZONTAL

- Personazhi në foto.
- Gigi-ish bomber italian.
- Fillojnë rubrikën.
- Një britmë në corrida.
- Tri të aparat në renditje
- Është lloj papagalli.
- Fare pa fe.
- Francesco te Roma.
- Është habitat pelikanësh.
- Në krye të skuadrës.
- Personazhi në foto.
- Ente Civile Autonome.
- Parashtesë për... vete.
- Një sportist në pistë.
- Sukur janë në krye.
- Një Garfunkel i muzikës.
- Norvegjia në tabela.
- Samuel bomber.
- Sapo fillojnë.
- Arben, që qe bomber i pahuarar i yni
- Është lojtari pas stopper-it.

VERTIKAL

- Kështu fillon argumenti.
- I ka të ndryshme liria.
- Një pjesë e europianeve.
- Inicialet e Seagal
- Fillojnë dobët.
- Role pa çifte.
- Poeti kur nuk pi.
- Është therëse dhe tallëse.
- Është cilësi.
- Kanë elementë për të kapur.
- Një shok armësh.
- Ansi futbollist.
- Janë skuadrat Zenit dhe Spartak.
- Stefano, që qe portier i Juves.
- Pinci... Dy herë mat.
- Tri të parat në Arlington.
- Niset pa çifte.
- Ariet pa re.
- Një sport me zbritje të lirë.
- Një dyshe në...skenë.
- Në fund të ndeshjes.
- Kufizojnë një djep.
- Errani teniste.
- Në fund të krahut.
- Argentina në tabela.
- Fillojnë lejen.
- Hetim pa kufij.
- Pak tolerante.
- Në fund majtas.
- Ndezur në aparaturet
- Fund hero.

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1 9

3	9	8	7	1	4	6	5	2
7	5	2	6	3	8	4	1	9
6	1	4	9	2	5	3	8	7
9	2	7	4	6	1	8	3	5
8	6	5	2	9	3	1	7	4
4	3	1	5	8	7	2	9	6
1	4	6	8	7	9	5	2	3
5	7	3	1	4	2	9	6	8
2	8	9	3	5	6	7	4	1

	2			3	5			
		5	2	8	4			1
1			6	5			8	
5	4			6		8	1	
	8	1	5		9	7	2	
	9	6		7			3	5
	5			9	8			2
4			7	3	6	9		
		8	1					4

HOROSKOPI

DASHI

Jeta sentimentale e çifteve do jete gjate gjithë kohës e mbrojtur. Jupiteri do e forcoje bashkëpunimin dhe komunikimin. Beqaret do fillojnë një aventure te bukur dhe mjaft emocionuese. Do ndihen me mire se kohet e fundit dhe nuk do ankoheni për vetminë. Nëse nuk pakësoni shpenzimet do keni tronditje te mëdha ne planin financiar. Shmangini ato.

LUANI

Jeta ne çift nuk do jete shume e mire gjate kësaj dite prandaj kujdes me hapat qe do hidhni. Me mire merrini gjerat shtruar dhe shijojni gjerat pak nga pak sesa te nxitoheni dhe te gaboni. Beqaret nuk duhet te përzgjedhin shume sepse çdo njeri ka te meta. Ne planin financiar situata nuk do jete e mire. Do keni disa vështirësi dhe kjo do iu shpërqendrojë.

SHIGJETARI

Venusi dhe Marsi premtojnë një dite te bukur për te dashuruarit. Do i jepni shume rëndësi si intimitetit ashtu edhe fjalës. Mbrëmja do jete e zjarrte. Me ne fund edhe beqaret do kenë mundësi te provojnë shijen e dashurisë. Ai qe do ua tregojë këtë është një person qe e keni njohur prej kohesh. Ne planin financiar do keni fat. Pa shume përpjekje do e stabilizoni situatën.

DEMI

Kjo do jete një dite reflektimi për te gjithë ata qe janë ne një lidhje. Do i pranoni disa gabime qe keni bere dhe do dini te kërkonit falje. Për beqaret ka shume mundësi te ketë takime interesante dhe afatgjata. Shfrytëzojini këto mundësi qe do iu jepen. Ne planin financiar do jeni shume te afte dhe do i menaxhoni me shume kujdes te ardhurat. Situata do jete e qëndrueshme.

VIRGJËRESHA

Jeta sentimentale e çifteve do jete e qete gjate kësaj dite. Ata qe kane kërkuar pasioni e madh do mërziqen paksa, por ne fakt është me mire te reflektoni pak mbi atë qe doni te bëni. Beqaret edhe pse e ndiejnë shume peshën e vetmisë nuk duhet te nxitohen dhe te pranojnë ftesat pa u menduar. Ne planin financiar do kryen transaksione me rëndësi dhe situata do stabilizohet.

BRICJAPI

Dite e animuar kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do provoni disa eksperiencia te reja dhe kjo do u mbaje zgjuar ndjenjat për partnerin. Beqaret do kenë takime te rëndësishme dhe interesante. Shfrytëzojini sa te mundni. Për shkak te shpenzimeve te shumta qe do kryeni situata financiare do jete e paqëndrueshme. Beni kujdes!

BINJAKËT

Jupiteri do ketë një ndikim te madh gjate kësaj dite ne planin sentimental te çifteve. Do tregoheni me te hapur me njeri-tjetrin dhe do i shprehni ato qe mendoni. Beqaret do mendojnë shume për jetën familjare dhe për miqtë dhe nuk do kenë kohe për dashurinë. financat do jete te paqëndrueshme kështu qe shmangni investimet e mëdha.

PESHORJA

Ate shumte do jene planetët qe do ndikojnë ne jetën tuaj sentimentale sot dhe do e bëjnë atë me te bukur. Shfrytëzojini çdo sekonde qe do jeni pranë partnerit dhe do përjetoni emocione pa mbarim. Për beqaret do jete dite pa fat kështu qe me mire te mos ndërmerri sfida. As financat nuk do jene ne gjendjen me te mire te mundshme, megjithatë probleme te mëdha nuk priten.

UJORI

Te gjithë yjet do tregohen te sjellshëm me ju dhe do ua bëjnë ambientin edhe me harmonik. Do jeni gjate gjithë kohës entuziaste dhe do kaloni një dite te bukur. Beqaret duhet ta lënë vetëm te lire dhe te përfitojnë nga ftesat qe do iu bëhen. Problemet e vogla financiare duhet t'i merrni me seriozitet sot. Mos lejoni qe situata te përkeqësohet edhe me tepër.

GAFORRJA

Do jeni me humor shume te mire gate kësaj dite dhe do jeni te gatshëm për ndonjë çmenduri te vogël ne çift. Partneri do jete i te njëjtit mendim me ju dhe do iu beje te ndiheni me se miri. Beqaret do takojnë shpirtin e tyre binjak ne momentin qe me pak e presin. Dielli do iu ndihmoje ne planin financiar dhe me ne fund do vendoset ekuilibri.

AKREPI

Ata qe janë ne një lidhje duhet te bëjnë kujdes gjate kësaj dite mos bien ne tundim. Do jene te shumte personat interesante qe do kërkojnë t'iu bëjnë për vete dhe ju mund te bini "pre" e tyre. Beqaret do e kenë me te vështirë për te kryer takimin qe kane ëndërruar. Ne planin financiar do tregoheni shume te zotet dhe pak nga pak do fillojnë disa përmirësime.

PESHQIT

Planetët nuk do ndikojnë aspak ne jetën tuaj ne çift dhe mund te kenë disa debate te zjarrta. Mundohuni te mos tregoheni shume kokëforte. Për beqaret mund te ketë dashuri me shukim te pare. Shikoni ne çdo moment rreth e rrotull. Sektori i financave do kenë disa tronditje. Ulini sa me shume shpenzimet nëse nuk doni te ngeletni pa asnjë para. Mund t'ia dilni edhe me pak.

PËRGJIGJE

M	E	T	A	L	I	K	U	R	A	T	
S	T	A	R	R	A	T	R	U	K	E	
N	T	E	A	T	E	R	K	I	M		
B	I	R	I	P	O	L	I	C	R	A	
R	A	T	P	O	L	E	M	I	K	A	T
O	T	P	O	L	I	F	E	M	I		
S	F	I	H	O	K	A	T	A	R	E	T
H	A	K	I	N	N	T	O	F	U		
I	K	I	M	I	N	T	I	N	A	R	
R	T	R	E	A	L	I	S	T	I	M	
A	O	R	T	E	A	H	L	A			
T	R	U	P	B	E	R	R	E	T	A	T

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

15	5	11		12		11	7	3	13	5		17		
3	8	5	6	2	9		10	5	7	5	18	2		
4		4	2	9	2	10	3	5		2	11	3	13	
		11	5	4	2	10	1	7	3		8	5	17	
			7	2	7	2		12	5	6	2	9	4	
12	5	9	9		7		5		17		3	16	2	
3	8	2		10	5	15		4	5	7	13	17		
4	2	10	2		9	5		2	8	16	2	7	2	
2	9	3			10	S	6	2	7		9	3	4	
10		9	15	2	E	6	6	2	10	3	5		12	2
1	8	2			8	N	16	2	10	15	18	2	9	9
7	8		1	16	D	2	9		3		13	5	9	2

VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR! THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!



BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War




BUNK'ART 2

- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist

- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



Ku ndodhet BUNK'ART 1?
Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut) - Tiranë



Ku ndodhet BUNK'ART 2?
Rr. Abdi Toptani
(përballë Bashkisë) - Tiranë

www.bunkart.al / info@bunkart.al

Prenotime / Reservations:

+355 (0) 67 20 72 905

